



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.06.2018, ora 13:00

Drejton tryezën e konsultimit:

Alket Hyseni – relator i projektligjit

Rendi i ditës:

Tryezë konsultimi për projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit;

Alket Hyseni - anëtar i komisionit dhe relator i projektligjit;

Elena Xhina - anëtare e komisionit dhe relatore e projektligjit;

Artan Hoxha - dekan i Fakultetit të Drejtësisë;

Joana Qeleshi - kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;

Henrik Ligor - ekspert

Dritan Reshka - ekspert;

Gjon Juncaj - Ekspert nga Departamenti Ligjor pranë Ambasadës Amerikane (OPDAT);

Brunilda Jani - Eksperte nga Departamenti Ligjor pranë Ambasadës Amerikane (OPDAT);

Koraljka Bumci - eksperte ndërkombëtare, Misioni Ndërkombëtar EURALIUS;

Gianluigi Pratola - ekspert ndërkombëtar, Misioni Ndërkombëtar EURALIUS;

Klodiana Vogli - eksperte vendase, Misioni Ndërkombëtar EURALIUS;

Maniela Sota - përkthyesë, Misioni Ndërkombëtar EURALIUS;

Mirela Prifti - përkthyesë, Misioni Ndërkombëtar EURALIUS;

Adrian Shega - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë;

Edis Ibrahim - Këshilltar i Ministres së Drejtësisë;

Klodian Haxhillari - Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve;

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Brendshëm;

Nikoll Rica - Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

Fatmir Shehu - Drejtor i Drejtorisë Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

Alba Thoma - sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Mbrojtjes;

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes;

Sokol Gugushi - Oficer i Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake

Ilda Koja - Drejtore e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

Kostaq Beluri - Prokuror në Sektorin e Verifikimit të Integritetit, në Prokurorinë e Përgjithshme;

Gerti Loli - Oficer i Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative në Prokurorinë e Përgjithshme;

Ilda Çela - Specialiste në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

Nertila Shabani - Përgjegjëse e Sektorit Juridik në ISHMPU, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

Bib Doda - Inspektor në ISHMPU; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

Besnik Muci - Prokuror në Prokurorinë e Krimeve të Renda;

Eneid Nakuçi - prokuror në Prokurorinë e Krimeve të Renda;

Florian Arapi - Oficer e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Renda;

Bledar Flaga - Oficer e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Renda;

Arben Vucaj - Oficer e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Renda;

Pirro Stefani - Oficer e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Renda;

Teuta Malaveci - Oficere e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Arison Puka - Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Arben Elezi-- Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Dritan Malaj - Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Lazer Tuni - Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Hilda Ruci - Oficere e Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

HAPET MBLEDHJA

Alket Hyseni - Kemi organizuar këtë tryezë të rrumbullakët në kuadër të diskutimeve për ligjin “Për Policinë Gjyqësore”, një ligj i rëndësishëm në kuadër të të gjithë paketës së reformës në drejtësi.

Jemi në fazën e dytë, në pjesën e dytë të kësaj pakete dhe menduam që është e domosdoshme të organizojmë edhe një tryezë të rrumbullakët për të dëgjuar mendimin e drejtpërdrejtë të ekspertëve, të vetë oficerëve të Policisë Gjyqësore, të prokurorëve, të përfaqësuesve, të partnerëve tanë në këtë reformë të madhe, me qëllim që në fund të realizojmë një ligj, i cili të mos jetë thjesht një ligj i ri, por të jetë një prurje e re, një vlerë e shtuar në punën e vetë oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe në thelb të rezultojë me një hetim profesional e cilësor në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, në përputhje edhe me politikën penale të organeve shtetërore.

Falënderoj për pjesëmarrjen, më lejoni ta filloj me përfaqësuesit e OPDAT-it, Gjon Juncaj; zonjën Koraljka Bumçi, eksperte ndërkombëtare e Misionit Ndërkombëtar EURALIUS; zotin Artan Hoxha, në cilësinë e Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, por edhe në cilësinë e ekspertit të lartë të reformës në drejtësi, sidomos në çështjet e Kodit të Procedurës Penale, ku kemi shumë nevojë për ekspertizën tuaj; zotin Julian Hodaj, zëvendësministër në Ministrinë e Brendshme; zotin Henrik Ligor dhe zotin Dritan Reshka, ekspertë të këtij ligj; zotin Kostaq Beluri, prokuror në Sektorin e Verifikimit të Integritetit, në Prokurorinë e Përgjithshme, që është ekspert i kërkuar nga parlamenti!

Po kështu, falënderoj edhe të gjithë prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore apo ekspertë të fushës që kanë marrë pjesë në këtë tryezë të rrumbullakët!

Duke bërë një hyrje të shkurtër, para se t’i jap fjalën kryetarit të Komisionit të Ligjeve, ne gjykuam se ka pasur disa variante në diskutimin e ligjit. Një variant ka qenë për krijimin e një trupe të plotë dhe të veçantë të Policisë Gjyqësore, e cila do të inkorporonte të gjitha strukturat aktuale, duke filluar që nga seksionet pranë prokurorive, shërbimet pranë Policisë së Shtetit dhe të gjitha shërbimet e tjera pranë institucioneve të tjera shtetërore të cilat kanë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore me një hierarki të përcaktuar dhe me kompetenca të përcaktuara.

Varianti i dytë është një variant më i avancuar i ligjit aktual, një variant më kërkuar ndaj vetë trupës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, pasi, aktualisht, ky ligj nuk e ka realizuar qëllimin e tij në gjykimin analizës që i është bërë sistemit të drejtësisë, duke çeduar thellësisht

në cilësinë e hetimit. Shpeshherë ka pasur mosmarrëveshje midis organeve të emërtesës dhe organit të procedimit penal.

Ka edhe plot problematika të tjera, ku nuk dua të ndalem.

Çështjet që ne kemi diskutuar fillojnë që nga problemet kushtetuese lidhur me involvimin e organeve të reja kushtetuese në këtë ligj, nëse është apo jo e mundur që organet kushtetuese, të cilave me ligj nuk u është dhënë kompetencë, ligjin e posaçëm të tyre apo me Kushtetutë, të përcaktojmë kompetenca specifike lidhur me emërtesën, për shembull, apo çështjet e ankimeve administrative për çështje disiplinore.

Elementi i dytë, dhe shumë i rëndësishëm, është harmonizimi me kërkesat e reja të Kodit të Procedurës Penale dhe konceptet e reja të sjella në kod.

Së treti, është i rëndësishëm nga ana funksionale efikasiteti i strukturës së re të oficerëve të Policisë Gjyqësore, pastaj vazhdojmë me statusin dhe karrierën e tyre, edhe në kushtet kur oficerët e policisë gjyqësore kanë humbur një element të rëndësishëm nxitës në punën e tyre që është promovimi si prokuror.

Së fundi, aspekti kryesor që kemi ngritur, por jo i fundit nga çështjet që mund të diskutohen organet e emërtesës, mënyra e transferimeve dhe komandimeve, mënyra e shkarkimit, procedimet disiplinore, strukturat e posaçme që duhet të ngremë për këto çështjet dhe brenda këtyre temave mund të ketë plot nëntema për të diskutuar.

Duke i uruar suksese kësaj tryeze, i jap fjalën kryetarit të Komisionit të Ligjeve, i cili ka qenë një mbështetës i fortë i kësaj tryeze dhe i debateve të vazhdueshme në të mirë të përmirësimit të këtij projektligji.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Në fakt, nuk do të zgjatem shumë në fjalën time përshëndetëse, sepse sot është e rëndësishme fjala juaj. Sot është koha që ju të flisni për një projektligj me të cilin ne mbyllim gjithë kuadrin ligjor që rregullon sistemin e drejtësisë penale në Shqipëri.

Natyrisht, këtij projektligji i ka paraprirë një kuadër i tërë ligjor në kuantin e reformës në sistemin e drejtësisë, duke filluar që me ndryshimet kushtetuese, ligjin “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, shumë i rëndësishëm është Kodi i ri i Procedurës Penale që ka hyrë në fuqi me 1 gusht 2017, ku janë hedhur edhe bazat ligjore të mënyrës së organizimit dhe funksionit të Policisë Gjyqësore.

Sot jemi te ligji kuadër i Policisë Gjyqësore, me të cilin, siç e thashë pak më lart, ne do të përmbyllim një kuadër të ri ligjor që rregullon dhe normon punën e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri.

Edhe një herë ju falënderoj për pjesëmarrjen të gjithëve pa përjashtim! Pjesëmarrja juaj sot në këtë format tregon nivelin e lartë të interesimit të njerëzve të praktikës për ligjin e policisë gjyqësore. Nuk ndodh shpesh që në tryeza të tilla të kemi kaq pjesëmarrje, por si duket edhe ne si organizatorë të kësaj tryeze të konsultimit publik si Komisioni i Ligjeve dhe këtu gjej rastin të falënderoj dy relatorët, kolegët e mi, zotin Hyseni dhe zonjën Xhina.

Ia ka vlejtur organizimi i kësaj tryeze dhe ky ka qenë edhe merakun ynë që ditën e parë kur e kemi futur këtë projektligj në kalendarin e punimeve të Kuvendit.

Le të themi se ky projektligj, nëse do të ecim sipas fazave dhe shpejtësisë që na e dikton kalendarin e punimeve të Kuvendit, do të duhet të kalojë në seancë plenare brenda këtij sesi parlamentar.

Në fakt, më tepër se sa ngutja për ta kaluar, na intereson cilësia e projektligjit. Edhe kjo tryezë sot është në funksion të cilësisë së këtij projektligji.

E them shumë hapur nëse nuk e kalojmë dot në korrik, nuk prish punë ta kalojmë edhe në shtator, po rëndësi ka të kemi një ligj për Policinë Gjyqësore, që në zinxhirin e hetimit penal t'i shërbejë më së miri cilësisë së hetimit penal.

Sot në këtë tryezë të konsultimit publik, përveç ekspertëve që kanë punuar me projektligjin, me draftin që tashmë është i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit, dhe që është pjesë e punimeve të komisionit, kemi edhe përfaqësues të misionëve që asistojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri, OPDAT-in e EURALIUS-in, të cilët në hartimin dhe draftimit të këtij projektligji kanë pasur dhe kanë ekspertët e tyre të nivelit të lartë, por është shumë e rëndësishme që në këtë tryezë të konsultimit kemi prezentë profesor Hoxhën, zonjën Qeleshi, zotin Ligori dhe zotin Reshka, të cilët kanë qenë edhe në grupin e punës për hartimin e Kodit të ri të Procedurës Penale, së bashku me zonjën Bumçi dhe përfaqësues të OPDAT-it.

E përmenda këtë fakt, sepse ligji i Policisë Gjyqësore është shumë i lidhur me Kodin e Procedurës Penale. Ne sot, në këtë tryezë, jemi shumë të interesuar të thithim mendimin e ekspertëve, që kanë hartuar Kodin e Procedurës Penale, të thithim mendimin e njerëzve të praktikës, prokurorëve, të cilët janë të pranishëm në këtë tryezë, por me shumë rëndësi është edhe mendimi i oficerëve të policisë gjyqësore, i atyre që preken drejtpërsëdrejti nga ky projektligj. Absolutisht që nuk ka ligj perfekt, ndaj ne nuk pretendojmë që, me miratimin e këtij projektligji të kemi zgjidhur gjithë problematikën që ka sot sistemi i hetimit në Shqipëri, apo dhe puna e Policisë Gjyqësore. E rëndësishme është që ligji që do të miratojmë të jetë më i mirë se ky që kemi, e pse jo, së bashku dhe me Kodin e ri të Procedurës Penale, të jetë një kontribut me vlerë për cilësinë dhe objektivitetin e hetimeve penale në Shqipëri.

Edhe një herë, ju faleminderit për pjesëmarrjen në këtë tryezë të konsultimit publik. Tani do t'ia kaloj përsëri fjalën kolegut tim, zotit Hyseni, për të moderuar këtë tryezë. Do të dëgjojmë me shumë vëmendje mendimin e secilit. Shfrytëzoj rastin edhe për një ftesë, përpos diskutimit të secilit prej jush në këtë tryezë, që sigurisht do të jenë të regjistruara në audio, për të qenë pjesë e debateve dhe diskutimeve tona në Komisionin e Ligjeve, t'ju lutem që secili të depozitojë edhe komentet me shkrim gjatë ditëve në vazhdim, për të pasur një panoramë të qartë të mënyrës se si do t'i reflektojmë në këtë projektligj.

Edhe njëherë faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke e hapur debatin, i cili do të jetë i lirë, së pari do të doja të bëja vetëm një ndërhyrje, për t'ua dhënë fjalën dy ekspertëve të ligjit. Pastaj, secili është i lirë që, lidhur me këto shqetësime që ne kemi, por dhe lidhur me çdo shqetësim tjetër që ju mund të keni, të marrë fjalën dhe të diskutojë. Ashtu siç edhe kryetari sugjeroi, do të donim që, përpos këtij diskutimi, brenda datës 22, që është fundi i javës tjetër, të na i sillni me shkrim, për t'i administruar më saktësisht e për t'i bërë pjesë të diskutimeve tona.

Zoti Ligori, zoti Reshka, cili të dojë nga ju, mund ta marrë fjalën i pari.

Dritan Reshka – Faleminderit, zoti Hyseni!

Të nderuar pjesëmarrës, ju falënderoj që jeni bërë pjesë e kësaj tryeze të rrumbullakët, e cila, sikundër u shpjegua, synon të realizojë diskutime, të thithë mendime për sa i takon draftit të ligjit “Për Policinë Gjyqësore”. Është momenti që, pavarësisht asaj që jemi përpjekur të paraqesim ne si grup pune, gjithsecili prej jush tashmë e ka një draft, siç tha zoti Manja, nuk ka ligj perfekt. Nuk pretendojmë që në këtë draft të kemi trajtuar në mënyrë shteruese të gjitha problematikat e aspektet që ne mendojmë se kanë të bëjnë apo ndikojnë në punën e Policisë Gjyqësore. Sigurisht, jemi përpjekur të adresojmë në këtë projektligj ato problematika, të cilat, gjatë diskutimeve në komision dhe gjatë periudhës së reformës u bënë pjesë e dokumentit analitik, pra problemet që dolën si rezultat i analizave të thelluara. Besoj se një pjesë të tyre i kemi adresuar, por sigurisht sot është rasti që gjithsecili prej jush të ketë mundësinë të ndërhyjë, të propozojë, e sigurisht të na japë ide, me qëllim që edhe ato që kemi bërë t'i përmirësojmë e t'i ndryshojmë, por edhe me ide të reja, të cilat, pavarësisht përpjekjes sonë, nuk kemi arritur t'i cekim dot, sepse, në fund të fundit, gjithmonë ka vend për sugjerime e përmirësime. Shpresoj se do të marrim më të mirën, do të thithim sugjerimet më të mira, me qëllim që më pas t'i reflektojmë, për t'i bërë pjesë të projektligjit.

Ju faleminderit!

Alket Hyseni – Kush dëshiron të marrë fjalën?

Dritan Reshka – Më fal! Ne, si grup pune, kemi përgatitur një listë me disa çështje për diskutim, në lidhje me të cilat do të kishim nevojë të dëgjonim edhe mendimet tuaja. Është një listë çështjesh, nga e cila besoj se ju është shpërndarë nga një kopje.

Në funksion të marrjes ose thithjes së mendimeve tuaja, ne kemi ngritur disa pika, të cilat, normalisht kanë qenë objekt diskutimi edhe gjatë mbledhjeve që kemi bërë në Komisionin e Ligjeve. Konkretisht, për atë pjesë që nuk e kanë listën e pyetjeve, unë po përpiqem t'i lexoj.

E para është: cili është mendimi juaj, se cilat kategori ose grada në Policinë e Shtetit duhet të marrin atributet e Policisë Gjyqësore? Sepse, mendimi ynë, si ekspertë, është se tashmë, siç është me ligjin ekzistues, jo të gjithë oficerët e Policisë së Shtetit, me grada të ndryshme, do të gëzojnë atributet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, por vetëm kategori të caktuara.

E dyta: çfarë formimi duhet të kenë ata? Duhet të kenë mbaruar Akademinë e Policisë, apo mund të kenë edhe formim profesional tjetër?

Pyetja e dytë është: përveç statusit të Policisë Gjyqësore, ligji për statusin e Policisë Gjyqësore a mendon se mund të bëhet referencë edhe te ligjet e tjera, për sa u takon aspekteve të ndryshme të statusit të Nëpunësit Civil, me disa specifikime në drejtim të pagesës, daljes në pension, apo duhet bërë referencë në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”?

Pyetja e tretë, që është shumë interesante dhe objekt diskutimi, është: a mund të kemi, a mund të krijojmë në kuadër të këtij projektligji 2 komisione me përbërje, i pari: 1 prokuror dhe 2 oficerë për sa u takon shqyrtimit të masave disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore dhe një komision tjetër i përbërë nga 2 prokurorë dhe 1 oficer për sa i përket momentit të rekrutimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore? Pra, oficerët e Policisë Gjyqësore nuk do të rekrutohen dhe nuk do të zgjidhen më nga ai organ monokratik siç është sot, por do të rekrutohen, do të përzgjidhen nga një organ kolegjal, i përbërë nga 2 prokurorë dhe 1 oficer në çdo prokurori të shkallës së parë. Nëse është kështu, komisioni i Policisë Gjyqësore do të mbetet vetëm si organ apelimi, komisioni që është parashikuar ju e keni pjesë të projektligjit, apo mendoni një organ apelimi për vendimin e dy komisioneve të mësipërme, apo duhet të ketë edhe kompetenca të tjera? A kemi nevojë që në ligj të përfshijmë një definicion më të qartë se çfarë janë shërbimet dhe çfarë janë seksionet, duke bërë edhe një parashikim për sa i takon lëndës që trajton secila nga këto dy struktura? Si do të jetë pagesa e seksioneve? A do të vetohen oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve? Nëse po, në cilën mënyrë? Sepse sot gjyqtarët dhe prokurorët, por njëkohësisht edhe oficerët e Policisë së Shtetit, oficerët e shërbimit të Policisë Gjyqësore janë në procesin e vetingut. Si duhet të rregullohen komandimet e përkohshme?

Do të donim një mendim për sa i takon promovimit të oficerit të shërbimeve të Policisë Gjyqësore, duke paraparë edhe mundësinë e kalimit të një pjese prej tyre në seksione.

Këto janë pak a shumë çështjet që kemi përgatitur. Nuk e di nëse është e mundur, që t'i mbani mend.

Henrik Ligori - Mirëdita!

Ju falënderoj që jemi në këtë tryezë të rrumbullakët për të diskutuar lidhur me këtë projektligj të rëndësishëm!

Unë dua të bëj një paraqitje të shkurtër të përmbajtjes dhe të logjikës së ndërtimit të këtij projektligji. Siç e dini, ka pasur një dokument analitik që studionte gjendjen e drejtësisë penale në Shqipëri. Atje pasqyroheshin edhe disa probleme që ishin vënë re në përditshmërinë e veprimtarisë hetimore të Policisë Gjyqësore, të cilat duhet të reflektoheshin duke përmirësuar ligjin ekzistues, ose duke krijuar një ligj të ri.

Problemi i parë dhe kryesor që është shtruar për diskutim është nëse Policia Gjyqësore do të funksionojë kështu siç ka qenë konceptuar dhe siç është ende me ligjin ekzistues apo Policia Gjyqësore do të jetë një trupë e veçantë, qoftë në Policinë e Shtetit qoftë në organet e tjera ligjzbatuese për të cilat ligji parashikon krijimin e një shërbimi të tillë, e cila do të kryente vetëm shërbime të Policisë Gjyqësore, nuk do të kryente funksione të natyrës administrative siç kryen sot Policia Kriminale, që përveç parandalimit të veprimtarisë gjurmuese, sa herë konstatohet një vepër penale, shndërrohet në Polici Gjyqësore dhe kryen ato akte të cilat i shërbejnë prokurorit të marrë nismat e tij lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale.

Projekti që keni përpara është i ndërtuar mbi këtë frymë, një trupë e veçantë, që kryen vetëm funksione gjyqësore. Kjo nuk është një gjë e thjeshtë. Lidhur me këtë temë ka diskutime të shumta. Ka argumente pro këtij organizimi, ka dhe argumente kundër. Ndoshta edhe për këtë do të dëshironim të dëgjonim mendimin tuaj.

Problemi tjetër i rëndësishëm lidhur me Policinë Gjyqësore ka të bëjë me organizimin në seksione dhe në shërbime të Policisë Gjyqësore.

Pjesa e shërbimeve të Policisë Gjyqësore, e cila funksiononte pranë seksioneve të prokurorive të rretheve në Dokumentin Analitik nuk u konsiderua një praktikë e mirë. Sot ideja është që shërbimet e Policisë Gjyqësore do të punojnë pranë Policisë së Shtetit dhe organeve të tjera të administratës publike, të cilat me ligj kanë të krijuar Polici Gjyqësore, kurse seksionet, në një numër më të reduktuar sesa janë aktualisht, do të punojnë pranë prokurorit, duke pasur një kompetencë të posaçme hetimore lidhur me ato vepra për të cilat nuk mund të hetojë dot Policia Gjyqësore e shërbimit.

Logjika, e cila mbështet këtë zgjedhje është fakti se duhet t'i jepet fund debatit se kush po i kryen hetimet, po i kryen prokurori, policia. Prokurori ka një rol të madh, siç e dimë, por ideja është që hetimet ashtu si edhe në vende të tjera të përparuara duhet t'i marrë përsipër dhe t'i kryejë Policia Gjyqësore.

Nuk duhet që këto hetime të mbahen brenda zyrave të prokurorisë, prokurori të delegojë vetëm oficerët të cilët i ka në seksionet e kontrolluara prej tij, por duhet t'i japë një hapësirë më të gjerë veprimtarisë hetimore të Policisë Gjyqësore.

Problem tjetër i rëndësishëm, që është një problem shqetësues që është adresuar për t'u zgjidhur në këtë projektligj është fakti që Policia Gjyqësore ose oficerët e Policisë Gjyqësore që merren me hetime, sidomos këtu bëhet fjalë për ata të shërbimeve, duhet që karrierën e tyre ta lidhin me rezultatet e hetimeve të kryera prej tyre. Pra, projektligji synon që oficerët e Policisë Gjyqësore që kryejnë hetime, t'i lidhë më ngushtë me rezultatet e punës së tyre në mënyrë që një hetim të nisur, ata të jenë të interesuar ta çojnë deri në fund, të jenë të interesuar që të ketë rezultate pozitive, të cilat nëpërmjet mekanizmave të caktuar ligjorë do të ndikojnë në karrierën e tyre të ardhshme, në kushtet kur siç u përmend nga parafolësit mundësia e avancimit të karrierës së oficerëve të Policisë Gjyqësore drejt caktimit të tyre në detyrën e prokurorit, tashmë është një problem i mbyllur dhe nuk mund të diskutohet më.

Në projektin që keni përpara ishte konceptuar mundësia që si rekrutimi, ashtu edhe promovimi në detyrë edhe përgjegjësia disiplinore e oficerëve të Policisë Gjyqësore të zgjidhej përpara një komisioni të posaçëm të krijuar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ky është varianti që ju është paraqitur, variant nga i cili është lëvizur për shkak se ligji i posaçëm nuk parashikon funksione të kësaj natyre për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Ky i fundit i ka detyrat e tij të përcaktuara në ligjin përkatës dhe në këto detyra nuk përfshihet fakti që ai duhet të funksionojë si risi disiplinore dhe si një komision rekrutimi për oficerët e Policisë Gjyqësore. Detyrat e këtij këshilli janë të hapura. Në njërin prej tyre thuhet se ka edhe detyra të tjera të parashikuara me ligj, por kjo është një çështje që nuk i përket kësaj tryeze, pasi duhet të shtrohet para konstitucionalistëve. Ndërkohë, varianti që është mendua është ai ekzistues për rekrutimin me komisione disiplinore në çdo prokurori, pastaj dhe një komision me një përbërje tjetër, i cili do të vendosë për rekrutimin dhe, si seli apelimi, për rastet e vendimeve disiplinore. Por këto janë variante të hapura, mbeten për t'u diskutuar dhe mund të përmirësohen me ndërhyrjet tuaja.

Problemi i fundit që dua të prek shqetëson më së shumti ish-oficerët e Policisë Gjyqësore, për pagën e tyre, në kushtet kur dihet që në fillim të muajit janar të vitit 2019, paga

e prokurorëve do të rritet. Ka një vullnet politik të mbështetur edhe nga ekspertët, që oficerëve të Policisë Gjyqësore t'u garantohet një pagë e pëlqyeshme, e pranueshme, që t'i nxisë ata të kryejnë sa më mirë të detyrës së tyre.

Këto janë pak a shumë çështjet kryesore dhe bashkë me ato që parashtroi zoti Reshka për diskutim sot, besoj se do të merret një kontribut shumë i vlerësuar nga ana jonë për ta reflektuar në tekstin e projektligjit në përmirësim e sipër.

Ju faleminderit!

Alket Hyseni – Kjo pasqyrë ishte e domosdoshme që pjesëmarrësit ta kenë më të qartë ku jemi me situatën e ligjit.

Do të doja ta merrte fjalën kushdo që mendon se mund të japë një produkt për ndonjë nga pikat.

Po, zoti Rica, përfaqësues i policisë.

Nikoll Rica - Faleminderit!

Unë jam përfaqësues i Policisë së Shtetit dhe duke qenë se është pyetja e parë që më drejtohet nga komisioni, unë po i përgjigjem. Cila kategori ose grada në Policinë e Shtetit, mendohet të ushtrojë atributet e Policisë Gjyqësore?

Mbi bazën e studimit dhe diskutimit që kemi bërë me të gjithë drejtuesit e policisë, që merren kryesisht me drejtimin e strukturave të Policisë Kriminale, por duke u nisur edhe nga përvoja e mëparshme, strukturat kryesore që duhet të merren me hetimin e krimit në Policinë e Shtetit, gjykojmë se janë këto:

E fillojmë nga niveli bazë, komisarati i Policisë. Mendojmë se e vetmja strukturë, që duhet të merret me hetimin dhe të gëzojë e ushtrojë atributet e Policisë Gjyqësore, është seksioni për hetimin e krimeve. Ky seksion në të gjithë organikën e Policisë së Shtetit, zë një përqindje mbi 1/10-ën apo 1/15-ën (varet nga numri i punonjësve të policisë) dhe është seksioni që merret me hetimin e të gjitha veprave penale që ka kompetencë vendore dhe territoriale. Këta, në funksion të hetimit në komisarati, u vijnë në ndihmë agjentëve të Policisë Kriminale edhe specialistëve të policimit në komunitet sipas ligjit të Policisë së Shtetit.

Nëse ngjitemi në një nivel tjetër, në drejtoritë vendore të policisë, ose, e thënë ndryshe, në drejtoritë nëpër qarqe, mendoj se strukturat që duhet të merren me hetimin e krimit, janë prapëseprapë strukturat e Policisë Kriminale, por janë zyrat rajonale që merren me hetimin e krimeve të rënda, me krimin ekonomik financiar, me trafiket të drogës dhe të veprave penale të korrupsionit. Edhe këtu futen agjentët e Policisë Kriminale, të cilët janë në mbështetje të këtyre strukturave. Te Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ne mendojmë që struktura e cila do të merret me hetimin e krimeve është vetëm Departamenti i Policisë Kriminale, që ka

në përbërje tri drejtoritë bazë: Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, Drejtorinë për Hetimin e Trafikeve dhe Drogës dhe Drejtorinë e Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Financiar, duke zbritur pastaj te Forca e Posaçme Operacionale, që është e angazhuar në veprime të drejtpërdrejta hetimore.

Nëse i krahasojmë këto funksione, që duhet të merren me hetimin e krimit, në kuadrin e të gjithë limitit organik që ka Policia e Shtetit, nga afërsisht 11 mijë funksione që ka policia (rreth 10 mijë i ka me status policor) vetëm 2295 duhet të jenë punonjës ose persona që do të merren me hetimin e krimit, pra do të ushtrojnë atributet e Policisë Gjyqësore. Duke iu referuar gradave që mbajnë këta punonjës policie dhe që përfshihen te strukturat e hetimit, mendoj të jenë punonjësit e policisë me gradë policore “inspektor i parë” dhe “inspektor i dytë”, se nuk ka gradë “kryeinspektor”, siç thuhet te projekti, specialistët me gradë “nënkomisar”, “komisar” dhe “kryekomisar”, por edhe “drejtues”, sepse zëvendës drejtorët e policisë nëpër qarqe, që mbulojnë hetimin e krimit, e kanë në varësi të drejtpërdrejtë këtë strukturë. Për sa i përket hierarkisë dhe nivelit të gradave, këta janë persona që mendoj se duhet të ushtrojnë atributet e Policisë Gjyqësore.

Unë u përpoqa t’i përgjigjem shkurtimisht pyetjes që bëhet për Policinë e Shtetit për sa u përket kategorive dhe gradave që do të kenë për të ushtruar atributet e Policisë Gjyqësore. Të neni 4 parashikohet një dispozitë që thotë: “Në raste të ngutshme të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit ushtrojnë atributet e Policisë Gjyqësore”. Unë mendoj se duhet bërë një rregullim.

E para, mbase te neni 2, te përkufizimet, të përcaktojmë çfarë quajmë rast të ngutshëm, sepse po t’i referohemi Kodit të Procedurës Penale, nuk e ka të përcaktuar rastin e ngutshëm. Kodi parashikon kushtet e flagrancës në rastet kur personi është në ndjekje penale. Mbase është e nevojshme ta specifikojmë rastin e ngutshëm.

E dyta, aty thuhet “të gjithë punonjësit e policisë”, nuk mund ta përdorim këtë frazë, pasi duhet thënë “punonjësit e policisë me gradë policore”, se rreth 2000 vetë i kemi civilë, por në kuptim të ligjit të policisë, i quajmë punonjës policie.

Për sa i përket pagës mendoj se punonjësit e Policisë së Shtetit, pavarësisht se te ne është mbi bazën e gradës, se kështu rregullohet me VKM, mundet që përqindjen e vështirësinë (se këta që punojnë në strukturat e policisë kriminale kanë një vështirësi më të madhe) ta rregullojmë me një VKM, me qëllim që këta punonjës të marrin një pagë më të lartë se sa marrin sot. Unë kam disa mendime të tjera që do t’i them më pas, pasi lidhen më shumë me riformulime dhe rregullime, kështu që nuk po ju ha më kohë.

Faleminderit!

Alket Hyseni - ...Faleminderit, zoti Rica!

Në fakt, në komision policisë i kishim ngritur disa detyra, një nga të cilat ishte çështja se çfarë projektesh ka Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme me strukturat që parashikohen të jenë në funksion të hetimit.

E dyta ishte kërkesa që ne patëm për parashikimin e numrit të mundshëm teorik të oficerëve, që me ligjin aktual gëzojnë atributet e oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Besoj se këto çështje morën përgjigje nga diskutimi i zotit Rica, i cili parashitroi edhe disa diskutime të tjera interesante për interpretimin e rastit të ngutshëm apo të ndonjë çështjeje tjetër.

Kush e dëshiron fjalën?

Po, zonja Bumçi.

Koraljka Bumçi – *(përkthen përkthyesja)* Faleminderit që ma dhatë fjalën!

Dua të them se kjo tashmë është e shprehur qartë edhe në ligjin për Policinë Gjyqësore, ku të gjithë policët, pavarësisht se mund të jenë në këtë detyrë, pra edhe civilë, e kanë të drejtën të merren me çfarëdolloj çështjeje të kësaj natyre. Kjo është e shprehur edhe në Kodin e Procedurës Penale. Mendoj se çdo polic, gjithashtu, është edhe një polic gjyqësor. Sigurisht, varet nga ju se çfarë do të vendoset, por unë doja të jepja opinionin tim. Me sa di unë për ligjin për Policinë e Shtetit, çdo polic është, gjithashtu, një nëpunës civil.

Mendoj të merret parasysh edhe ajo që shprehet në ligjin për prokurorinë dhe përcaktimi që bëhet aty për Policinë Gjyqësore. Sigurisht, me një status të posaçëm, me një rrogë të posaçme, e kështu me aradhe... Gjithashtu, do të keni në detyrë edhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Alket Hyseni - Faleminderit, zonja Bumçi!

Në fakt, është një shqetësim që është ngritur. Besoj se zëvendësministri do të replikojë direkt.

Legjislacioni aktual parashikon që çdo punonjës policie gëzon atributet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës dhe të ligjit për oficerët e Policisë Gjyqësore. Pra, ajo është forcë e madhe, sepse përcakton kufizimet sipas ligjeve specifike.

Besoj se ne kemi gjetur në masë dakordësinë, që jo çdo punonjës policie do të ketë statusin e Policisë Gjyqësore. Megjithatë, për këdo që ka një opinion ndryshe nga ky apo në mbështetje të tij, mund të shprehet zoti Hodaj.

Julian Hodaj – Faleminderit!

Vetëm për të sqaruar atë që tha zonja Bumçi. Policia e Shtetit ka tre lloje punonjësish: ka punonjës policie, nëpunës civilë dhe punonjës administrativë. Ata që gëzojnë statusin si punonjës policie janë (drejtor Nikolla mund të më korrigjojë) rreth 9600-9700 punonjës. Nuk

kanë statusin e nëpunësve civilë dhe nuk kanë statusin e punonjësve administrativë. Të tjerët janë në minorancë.

Ligji për Policinë e Shtetit përcakton aktualisht që çdo punonjës policie me gardë policore mund të ushtrojë funksionet e Policisë Gjyqësore. Ne jemi në një proces amendimi të ligjit për Policinë e Shtetit dhe, pa dyshim, në drejtimin që do të ecë ligji për Policinë Gjyqësore, këto ndryshime do të reflektohen edhe tek ai ligj, në mënyrë që të mos kemi përplasje ndërmjet dy ligjeve.

Shkurtimisht, sepse nuk dua të përsëris ato që kemi thënë me grupin e punës, ne kemi qenë pjesë e një grupi pune më të ngushtë dhe kemi diskutuar për përmbajtjen e këtij projektligji. U qëndrojmë atyre që kemi thënë atje, që ideja e ushtrimit të funksioneve të Policisë Gjyqësore nuk duhet të lidhet me gradat, por duhet të lidhet me strukturat, që do të thotë se punonjësit e një strukture të caktuar në Policinë e Shtetit, të cilët janë të ngarkuar me hetimin e veprave penale, automatikisht, marrin statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore në momentin kur emërohen në këtë detyrë.

Për sa i përket kontrollit, mendojmë se rekrutimi duhet të vazhdojë sipas ligjit aktual të Policisë së Shtetit, pra me mekanizmat që ekzistojnë sot.

Për sa i përket promovimit dhe disiplinimit nuk jemi kundër idesë së një komisioni të përbërë nga përfaqësues të prokurorisë dhe të Policisë së Shtetit, në mënyrë që këtyre punonjësve t'u garantohet meritokracia dhe qëndrueshmëria në detyrë.

Për çështjet e tjera mund të diskutojmë në një moment tjetër.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit juve, zoti Hodaj! Ishit i qartë dhe konciz.

Zoti Loli, keni fjalën.

Gerti Loli – Kisha një koment për trajtimin financiar, meqë u diskutua edhe më përpara. Mendoj se duhet të ruhet e njëjta balancë që ka dhe ligji aktual për pagën e oficerëve të Policisë Gjyqësore. Vjetërsia në punë duhet rregulluar. Ne e kemi 2% mbas vitit të pestë, por mendoj të bëhet si e prokurorëve, që në vit të parë. Ky është mendimi im. Gjithashtu, edhe kur ka vështirësi në lidhje me prokurorinë, kur prokurorët përfitojnë shtesë mbi pagën, për shembull, SPAK-u apo ndonjë task forcë tjetër. Në këtë pjesë mund të rregullojmë edhe përqindjen shtesë mbi Policinë Gjyqësore të shërbimeve.

Kemi edhe komente të tjera, por mund t'i bëjmë me shkrim, para datës 22, siç diskutuam.

Alket Hyseni – Unë do të nxisja edhe zotin Beluri, si një nga njohësit shumë të mirë të Policisë Gjyqësore dhe si ekspert i ftuar posaçërisht nga komisioni, për të dhënë opinionin e tij.

Më pas fjalën e ka zoti Muçi.

Kostaq Beluri – Për të mos e shpërndarë debatin, unë doja t'i shkoja dinamikës së diskutimeve që kemi bërë me grupet teknike.

Për mua, nuk vlen të diskutohet më pjesa e funksioneve të Policisë Gjyqësore. Ne jemi të detyruar t'u shkojmë parashikimeve që ka bërë Kodi i Procedurës Penale. Ai ka parashikuar seksionet pranë prokurorive dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore, duke pasur parasysh edhe Byronë... Duke qenë se këto janë funksionet, ky ligj duhet të fokuset në zgjidhjen e problemeve të këtyre funksioneve.

Radhën që shkoi e lamë të diskutojm kushtetutshmërinë e komisionit. Unë do të isha i interesuar, meqenëse kemi pasur edhe debate, të diskutojmë dhe dikush të shprehet për kushtetutshmërinë e komisionit, pasi është bërë pengesë për të ecur më tej me ligjin.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Beluri!

Është e vërtetë që një moment shumë i rëndësishëm (unë e citova edhe te pikat për diskutim) është çështja e diskutimit rreth kushtetutshmërisë që parashikohet në ligj, për strukturën e re të komisionit, i cili do të marrë disa kompetenca që burojnë nga KLP-ja dhe KLGJ-ja, ku ligji specifik nuk ua jep këtë kompetencë, po ashtu edhe Kushtetuta. Ka pasur një debat, për një nga nenet ku flitej për kryetarin, jo për vetë KLP-në, te kompetencat, në Kushtetutë dhe në pikën e fundit parashikoheshin edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

Diskutimi është: a mundemi ne ta shtrijmë këtë kompetencë të kryetarit në këtë ligj indirekt? A mundemi ne që parashikimet, që nuk janë në ligjin specifik, t'i shtojmë me ligje të një shkalle hierarkie më të ulët sesa ai ligj specifik?

Këto pyetje janë rreth kushtetutshmërisë dhe besoj se do të donim të kishim një opinion, sepse në këtë aspekt është mjaft e rëndësishme, besoj se do të kemi një opinion edhe nga përfaqësuesit dhe ekspertët e nivelit të lartë. Unë dua t'jua përmend shprehimisht mbështetjen e vazhdueshme që kemi pasur nga OPDAT-i dhe EURALIUS-i, ata ndoshta po rrinë pak në heshtje, sepse kanë qenë pjesë e shumë diskutimeve që ne kemi pasur këtu, por ata janë të paçmuar për punën tonë në këtë aspekt, përpos këtyre duan apo nuk duan ata, ne nuk i lëshojmë dhe do t'i kemi për diskutime deri në fund të procesit. Do të doja opinione edhe nga persona të tjerë. Kush e do fjalën?

Ju kërkoj ndjesë, sepse nuk ju përmenda edhe një përfaqësuese tjetër të rëndësishme nga gjyqësori, zonjën Qeleshi, një eksperte e shkëlqyer e Kodit të Procedurës Penale, e cila mund ta marrë fjalën kur të dojë.

Fjalën e ka zoti Muçi.

Besnik Muçi – Faleminderit për ftesën!

Nëse më lejoni, unë kam një këndvështrim ndryshe për ligjin e Policisë Gjyqësore. Natyrisht, duke shprehur mendimin tim kolegët e mi të seksioneve të Policisë Gjyqësore mund të më turren të gjithë, por këtë këndvështrim e kam pasur që para 10 vjetësh.

Para 10 vjetësh, rastësisht kam qenë anëtar i një komisioni të ngjashëm për ligjin e Policisë Gjyqësore, ku edhe në atë kohë e kam shprehur publikisht që një ligj i tillë për Policinë Gjyqësore duhej konceptuar nga parimi: “Hetimi është funksion ekzekutiv”. Pra, duke qenë një funksion ekzekutiv, do të jetë totalisht përgjegjësi e institucioneve të qeverisë. Në vështrimin tim, duke qenë totalisht përgjegjësi e qeverisë, duhet lënë ta kryejnë të gjitha mekanizmat, institucionet që janë nën funksionin administrativ të qeverisë.

Unë mendoj, duke qenë se ushtroj detyrën e prokurorit prej rreth 15-16 vjetësh, nisur edhe nga përvoja personale, që një sistem i tillë miks i organizimit të Policisë Gjyqësore nuk është eficient. Siç edhe jua thashë, kolegët e mi mund të më turren, por për mua funksionet duhet të fshihen dhe nuk duhet të ekzistojnë si funksione të Policisë Gjyqësore dhe hetimin duhet ta kryejë Policia e Shtetit. Seksionet nuk kanë eficiencën e duhur, sipas mendimit tim, edhe në rastet kur Policia e Shtetit e ka të vështirë ose të pamundur të kryejë hetime për shkak të konflikteve të interesit apo të situatave që ka ligji, të cilat i përmendi edhe zoti Ligor, këto hetime duhet t’i bëjë vetë prokurori. Për mendimin tim, prokurori duhet të marrë rolin e drejtuesit dhe të kontrolluesit të hetimeve. Prokurori aktiv nuk duhet të ketë ndonjë rol, përveç ndonjë rasti ekstra ose të jashtëzakonshëm, në hetimin e çështjeve, sepse duke pasur rol aktiv dhe kontrollues njëkohësisht është konflikt interesi, sepse nuk mund të kesh edhe rol aktiv në hetim, edhe kontrollues i hetimeve.

Në këtë frymë duhet parë edhe ky ligj, duke rregulluar detajet se si do të funksionojë Policia Gjyqësore brenda strukturave të Policisë së Shtetit, sepse punonjësit e Policisë së Shtetit do të kenë ose jo status, në varësi të detyrave që do t’u lërë prokurori. Punonjësi i Policisë së Shtetit do të marrë edhe atributet e Policisë Gjyqësore. Unë vlerësoj që prokuroria, sepse është një eksperiment i stërzgjatur që po vazhdon dhe kam frikë se i njëjti diskutim do të bëhet edhe pas 10 vjetësh, kur ky ligj do të ndryshohet përsëri, duhet të marrë pozicion kushtetues, të kontrollojë hetimet dhe të fajësojë akuzën në gjyq. Hetimi është në thelb funksion ekzekutiv dhe duhet të kryhet nga institucionet ekzekutive. Me këtë ligj, madje shoh një diskordancë ose

një mënyrë veprimi jo në unision me mënyrën e krijimit të SPAKU-t dhe të Byrosë. Pra, ne i kemi krijuar SPAKU-t një institucion totalisht të pavarur, i cili do të marrë dhe do të menaxhojë informacion, do të ketë rolin e Policisë Gjyqësore, rol operacional e të tjera, pra do të jetë edhe një polici më vete, kurse për pjesët e tjera të hetimit vazhdojmë me këtë miksin tonë, që për mua nuk ka eficiencë maksimale.

Gjithashtu, në vlerësimin tim, shërbimet e Policisë Gjyqësore duhen parë edhe në termat siç janë shërbimet. Të gjitha institucionet dhe mekanizmat që krijohen brenda këtyre shërbimeve si komisione apo drejtori i quaj të panevojshme, madje ato ulin rendimentin e punës. Policia e Shtetit ka një strukturë, e cila nga pikëpamja administrative funksionon brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Përse ne duhet të ndërtojmë ministruktura brenda kësaj strukture për Policinë Gjyqësore? Këtë nuk e kam kuptuar dhe nuk kam për ta kuptuar asnjëherë.

Natyrisht, përveç ndonjë mekanizmi që mund ta ketë KLP-ja në raport me punonjësit e policisë, ata që do të kryejnë funksionin e Policisë Gjyqësore, pjesa tjetër për mua është në dorë të prokurorit të çështjes, të oficerit të Policisë së Shtetit, i cili ka edhe attribute të Policisë Gjyqësore, ka përgjegjësinë sipas Kodit të Procedurës Penale ta rregullojë qartësisht procedurën dhe kaq.

Mua më duket se ne po e ndërlikojmë procesin e hetimit duke vazhduar të këmbëngulim për një ligj të posaçëm për Policinë Gjyqësore me struktura dhe mekanizma të posaçëm. Nuk e kam kuptuar asnjëherë qëllimin dhe eficiencën e këtij lloj ligji.

Po i drejtohem zotit Junçaj. Përvoja amerikane shkon në këtë aspekt, në drejtimin ose krijimin e një strukture unike, siç është Byroja, e cila do të ketë që nga marrja e informacionit deri në përfundimin e hetimeve, ose krijimi i këtyre mekanizmave të ndërmjetëm, duke e pjesëtuar, duke çuar disa oficerë të Policisë Gjyqësore pranë zyrave të prokurorisë dhe më pas t'ia lënë në dorë prokurorit të vlerësojë se çfarë hetimi do të kryejë unë me oficerët e mi, çfarë do t'i dërgoj Policisë së Shtetit, por në këtë mënyrë shpërndahet përgjegjësia dhe humbet eficiencia e hetimit, sepse hetimi është edhe përgjegjësi. Në fund të fundit ai që do të ketë të drejtën, sepse do të ketë të drejtë të plotë, si ekzekutivi në këtë hetim, do të ketë edhe përgjegjësinë.

Pra, në këtë aspekt ky ligj duhet parë. Nuk dua të diskutoj detajet dhe mënyrën e brendshme të organizimit, sepse mekanizmat e brendshëm të Policisë Gjyqësore nuk arrij t'i kuptoj, krijimin e komisioneve, të drejtorive, drejtorët e Policisë Gjyqësore...

Ne ose duhet të krijojmë një strukturë të posaçme, të pavarur, që do të merret vetëm me hetimin, duke e shkëputur edhe nga Policia e Shtetit, ose krijimi i këtyre mikseve të tilla, nuk po i përsëris fjalët...

Unë këtë mendim kam, më falni se bëra një vështrim të tillë dhe ju nxora nga mënyra juaj e të konceptuarit, por ky është vështrim im. Para disa vjetësh kam shkruar diçka për këtë çështje në një revistë shkencore, se si duhet konceptuar hetimi. Ne konceptimin e hetimit e kemi ende të paqartë, ky është mendimi im si prokuror.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Muçi!

Për ne nuk është diçka e re, por është një nga aspektet e këndvështrimeve për ligjin e ri, për funksionin e trupës së oficerit të Policisë Gjyqësore, por pikërisht ky është qëllimi i kësaj tryeze, të diskutojmë dhe të nxjerrim variantin më të mirë.

Nëse profesor Hoxha do të më lejojë, unë do të doja të shfrytëzonim eksperiencën shumëdimensionale të profesor Hoxhës, qoftë në aspektet akademike, por qoftë në aspektet e përkatësisë si ish- anëtar i Gjykatës së Lartë, gjithashtu, eksperiencën e veçantë në çështjet e ekspertizës së lartë për reformën zgjedhore dhe eksperiencën në fushën procedurës penale.

Rreth këtyre pikave të diskutimit, urdhëroni zoti Hoxha.

Artan Hoxha- Faleminderit për vlerësimin! Në fakt, ma vështirësove të folurin pasi më the gjithë këto gjëra të mira.

Unë ju kërkoj ndjesë, sepse nuk e kam parë në detaje projektin, por mund të them disa konsiderata të përgjithshme fillimisht sa u përket problematikave, që lidhen me drejtësinë penale gjatë procesit të reformimit të drejtësisë penale, për të cilën tashmë ne kemi një korpus ligjor me ndryshime kushtetuese në të. Ajo që u konstatua ishte se pjesa më e dobët e procesit penal është pjesa e hetimit paraprak dhe secili aktor kishte pjesën e vet të defekteve në këtë fazë të hetimit, kështu që nga disa lëvizje të mëdha të nivelit kushtetues dhe ligjor të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, siç ishte decentralizimi i prokurorisë, vendosja e kontrollit të gjyqtarit të seancës paraprake në përfundimin e hetimit, elementi tjetër që vjen si komplementar dhe që vjen për të plotësuar dhe fuqizuar fazën e hetimit paraprak që, në fakt, nga pikëpamja e procesit të provuarit është edhe pjesa kryesore e zbulimit të rrethanave të veprës penale, autorëve e të tjera, që pastaj duhet të verifikohen dhe të gjejnë përfundimin e saktë në gjykatë, është edhe riverifikimi i Policisë Gjyqësore jo sa u përket funksioneve, sepse ato janë të përcaktuara, siç tha zoti Beluri, por sa u përket organizimit dhe funksionimit të policisë Gjyqësore për të rritur efektivitetin e saj.

Kishte disa debate lidhur me vazhdimësinë e Policisë Gjyqësore me funksionet e saj pa i shkëputur si një e tërë, ose ishte nevoja të specializim aspekte të policisë me elementet e hetimit dhe të ruanimit interesin e veprimtarisë policore deri tek ajo hetimore, ose një variant ishte që strukturat e Policisë Gjyqësore të jenë pothuajse të organizuara brenda Policisë së Shtetit, por me funksione thuajse tipikisht të hetimit, ato që quhen funksione të Policisë Gjyqësore.

Ushtrimin e parë ne e bëmë të ligji për organet e luftës kundër krimit të organizuar dhe kundër korrupsionit, me krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të funksionimit të saj dhe strukturave që ajo ka.

Kjo që propozohet është afër saj, sepse ajo është një strukturë e organizuar në mënyrë qendrore dhe ka shërbimet e saj në Policinë Gjyqësore. Kurse ideja e zhvillimit të Policisë Gjyqësore dhe debatet që janë bërë edhe me strukturat e policisë në atë kohë, është që veprimtaria policore të zhvillohet normalisht, veprimtaria e hetimit të zhvillohet normalisht, por struktura e policisë të mos jetë e shkëputur dhe interesi të jetë i njëjtë për policinë. Si problematikë kemi konstatuar që mosfunksionimi i Policisë Gjyqësore ishte autoriteti i fortë i strukturave policore drejtuese në veprimtarinë e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilët nuk garantojnë dot as sekretin e hetimit, as normalitet në momentet kur drejtuesi i strukturës policore mund të lëvizte jo nga çështja, por edhe nga vetë funksioni që ai mbante dhe kjo nuk garantonte një hetim të vazhdueshëm të pavarur dhe ato elementet thelbësore që procesi penal ka. Kështu që unë mendoj se këtu jemi para një situatë që pak a shumë shkon drejt atij organizimi që Byroja Kombëtare e Hetimit ka, pra shkohet drejt strukturave të përqendruara të hetimit brenda forcave policore, por edhe jashtë tyre sipas fushave të tjera të veprave penale.

Është një zgjidhje, por unë, me aq sa pasqyloj se ka ende vend për të punuar në projekt, sepse ky është një projekt shumë i rëndësishëm dhe, ashtu siç tha zoti Muçi, është e rëndësishme të ndahen mirë ato që janë funksione të hetimit, ato që janë funksione të ndjekjes penale dhe të raportit të krijohet nga pikëpamja ligjore midis prokurorit dhe policisë që zhvillon hetimet.

Njëkohësisht duhet harmonizuar me kujdes ligji për Policinë e Shtetit me ligjin për Policinë Gjyqësore, sepse mund të krijojë problematikë.

Pra, këto ligje duhet të ecin bashkë dhe unë mendoj se edhe në ligjin për Policinë e Shtetit, nëse do të ecet pak a shumë me këtë orientim, ka nevojë të verifikohet vetë ai ligj, sepse ai ka nevojë për amendime.

Mund të kem shumë mendime, por ajo që dua të theksoj është përfshirja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Krijimi i një strukture, siç është drejtori i Policisë Gjyqësore, na çon drejt

një organi hetimi, i cili krijohet pothuajse më vete, si dikur hetuesia që kemi pasur. Nuk është si ajo, për këtë të jemi të sigurt, por figura e drejtorit të Policisë Gjyqësore, komisioni pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë na fusin në një moment që është shumë i fortë nga pikëpamja e rregullimit ligjor dhe që duhet menduar mirë, sepse mund të ngatërrohen funksionet e policisë me funksionet e prokurorisë, jo në kuptimin substancial, por të mënyrës së veprimtarisë së përbashkët të dy strukturave, të cilat në fund të ditës janë struktura më vete dhe kanë funksionet e tyre.

Së fundi, ajo që kam frikë shumë në këto dispozita tranzitore, pashë se ato ishin si ato dispozitat e ligjeve të mëparshme, që kemi kaluar. Unë nuk e di se ku i gjemë 270 ditë 240 ditë, pra i vëmë edhe me ditë fikse. Janë të rrezikshme këto, sepse po ndodh siç ndodh sot me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me Këshillin e Lartë Gjyqësor me fillimin e funksioneve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit, dhe gjykatës, të cilave fillimisht iu lamë 300 ditë, por kaluan edhe më tepër se 300 ditë. Ndaj, nuk duhet të jemi kaq fiks në përcaktime, sepse nuk e dimë ende kur do të krijohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe pastaj komisionet që krijohen brenda Këshillit të Lartë të Prokurorisë, edhe të vendosen afatet që do të vijnë më pas.

Do të doja që të bënim kujdes me dispozitën tranzitore, sepse gjithmonë na ka krijuar probleme edhe për sa i përket hyrjes në fuqi të ligjeve të tjera. Duhet të garantojmë atë që thuhet në paragrafin e parë të dispozitës tranzitore: “Organizimet aktuale mbi të cilat funksionon Policia e Shtetit dhe strukturave që zhvillojnë hetimet” dhe edukimin, që është një nga pyetjet se si do të edukohen ata që do të ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore. Çfarë funksionesh do të ketë Akademia e Sigurisë? Në qoftë se do t’i japim një status të veçantë, sikurse propozohet, atëherë ky status duhet të shoqërohet edhe me edukimin e tyre profesional, edhe mënyrën se si ata hyjnë në karrierë nga pikëpamja e kritereve të shkollimit dhe karrierës profesionale.

Mund të jap edhe mendime konkrete me shkrim, edhe terma e rregullore të posaçme. Nuk kemi pse t’i përcaktojmë në rregullore, janë aktet ligjore që dalin në zbatim të ligjit.

Fakti që është organizuar sipas këtij projekti, po të shohësh nenin 14, ai citon se: “Seksionet e Policisë Gjyqësore krijohen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në Prokurorinë e Përgjithshme”. Po ta marrim si strukturë, funksionet e Policisë Gjyqësore, mund të kemi nevojë t’i kryejmë edhe në prokuroritë e gjykatave të Shkallës së Dytë. Ju do të thoni: “Çfarë do të bënte një oficer i Policisë Gjyqësore në Shkallën e Dytë në gjykim?”, por kjo varet nga mënyra se si është strukturuar. Deri sa është strukturuar me drejtorë të Përgjithshëm, atëherë këto shërbime do të kishin nevojë të kishin të gjitha strukturat e organizimit gjyqësor, por nuk jam i mendimit se duhet patjetër, thjesht e ngre si pyetje në

versionin që është paraqitur. Nëse ky do të ishte versioni përfundimtar, mendoj se ka nevojë për t'u parë me kujdes, sepse kjo është çështje vullneti, se cila zgjidhje do të propozohet në fund.

Faleminderit!

Alket Hyseni - Faleminderit, profesor!

Ndërhyrja juaj ishte shumë e vyer!

Dëshiron dikush tjetër që të marrë fjalën?

Dritan Malaj - Përshëndetje!

Quhem Dritan Malaj, jam oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Tiranës.

Ne kemi nisur një propozim në lidhje me projektligjin, dy herë, sepse herën e parë u ndryshua. Dua të trajtoj dy-tri pika të këtij projektligji: te neni 1 thuhet: “Në referim të nenit përcaktohet objekti i ligjit, parashikohet se ky ligj normon parimet dhe rregullat për organizimin e funksionit të shërbimit dhe seksionit të Policisë Gjyqësore, veprimtarinë e tyre dhe statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore”. Ne nuk e kuptojmë se çfarë është statusi i Policisë Gjyqësore! Pse? Ky ligj në asnjë nen nuk jep përkufizime, apo të sqarojë shprehimisht se çfarë nënkuptohet me këtë term. Aty ka vetëm disa detyrime të oficerit të Policisë Gjyqësore dhe nuk ka asnjë të drejtë të parashikuar, ndërkohë që ligji për statusin e gjyqtarit, apo prokurorit është i parashikuar.

Gjithashtu, mendojmë se në këtë ligj duhet përcaktuar qartë statusi i oficerit të Policisë Gjyqësore.

Paga mbetet përsëri një problem, të cilin e trajtoi dhe kolegu pak më parë. Është një problem që prek oficerët e seksioneve, duke qenë se nuk mund të konsiderohemi as punonjës të administratës së shtetit, se një hetues nuk mund të jetë punonjës i administratës së shtetit, pa dashur të quajmë termin e vjetër “hetues” gjithashtu, jemi në një pozicion që kemi statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore, ndërkohë që nuk kemi grada të Policisë Gjyqësore dhe as të Policisë së Shtetit. Pra, në cilat seksione jemi të kanalizuar ne oficerët e Policisë Gjyqësore?

Lidhur me pretendimin e prokurorit Muçi për t'i shkrirë këto seksione, unë nuk jam dakord, pasi seksionet e Policisë Gjyqësore kanë treguar gjatë gjithë kësaj periudhe, megjithëse unë jam i ri në këtë detyrë prej tri vitesh, se kanë nxjerrë edhe kuadro, të cilët sot janë prokurorë dhe drejtues. Pra, nuk mund të themi që këto seksione nuk funksionojnë, apo nuk janë të domosdoshëm për hetim në prokuroritë e rretheve.

Gjithashtu, do të doja të thosha diçka për drejtorin e Policisë gjyqësore. Në një pikë të nenit citohet termi: “Ai delegon”. Çfarë doni të thoni me këtë? Delegimi nuk i takon atij, nuk është ai personi i përcaktuar në Kodin e Procedurës që delegon në një hetim. Kështu që edhe

kjo duhet parë, sepse në një moment të dytë mund të krijojë një problematikë, që nesër mund të jetë shumë e madhe, pasi këtë kompetencë mund ta marrë një person që nuk i takon.

Për sa i përket emërimit të oficerit të Policisë Gjyqësore propozojmë që emërimi të bëhet nga KLP-ja, por duke qenë se në ligjin për KLP-në nuk është e parashikuar, atëherë të shikohet ky komision që do të ngrihet, pasi edhe ngritja e një komisioni me dy oficerë dhe një prokuror, gjithmonë lë cedim në vetvete, pasi gjithë problemi është tek ana e objektivitetit.

Kemi prekur edhe disa problematika të tjera, siç janë: në Byronë e hetimit, oficerët e Policisë Gjyqësore quhen hetues dhe ne quhemi oficerë të Policisë Gjyqësore, por këto mund t'i shikoni duke qenë se ligji për Byronë e Hetimit është i veçantë. Nuk e di se si mund të rregullohet kjo!

Gjithashtu, në ligj referohen disa herë termat “Drejtori i Policisë së Shtetit dhe punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të jenë me arsimin e policisë” dhe nuk parashikohet që mund të jetë një jurist. Në fund të fundit, gjithçka bazohet në terma juridikë. Çdo njeri që e çojmë para drejtësisë, e çojmë në bazë të sistemit të drejtësisë. Pra, me gjithë respektin, nuk mund të themi që një punonjës i policisë, që ka bërë shkollën e policisë, të jetë jo i barabartë, ose “i përzgjedhuri”, sepse oficeri tjetër është jurist.

Këto ishin disa nga shqetësimet që kishim, të cilat do të donim të përcaktoheshin në ligj.

Më falni, kisha edhe diçka tjetër: në shumë vende në ligj thuhet: “Ulet apo ngrihet në detyrë oficeri i seksioneve”. Unë hyj sot në këtë pozicion pune dhe, në qoftë se karriera ime do të ecë mirë, në pension do të dal përsëri oficer i Policisë Gjyqësore, ndërkohë karriera e mëparshme, e parashikuar për ne në ligjin e vjetër, lidhej me mundësinë për të kaluar prokuror. Gjithashtu, në germën “ç” të pikës 2 të nenit 148 të Kushtetutës është parashikuar që kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorit parashikohen me ligj. Pra, ne jemi juristë. Ky është interpretim. Germa “ç” e pikës 2 të nenit 148 mund të interpretohet. Në qoftë se është vullneti, mund të gjendet zgjidhja. Nuk do të thotë se Kushtetuta e ka lënë pa zgjidhje, pra ka thënë vetëm me Shkollën e Magjistraturës. Në qoftë se nuk është kjo mundësi, të na jepet një mundësi në Shkollën e Magjistraturës që ne të konkurrojmë brenda grupit tonë dhe të përcaktohen disa kuota apostafat për këta oficerë, të cilët duan të hyjnë në Shkollën e Magjistraturës, por duhet të konkurrojnë brenda llojit të tyre. Këto janë disa mendime që kishim.

Alket Hyseni – Ju falënderojmë, sepse na i keni nisur ato. Janë disa oficerë të Policisë Gjyqësore që kanë sjellë sugjerime, të cilat janë shumë të vlefshme. Prandaj edhe sot do t'ju ftoj të jeni më aktivë, sepse, tek e fundit, po diskutohet një ligj që prek drejtpërsëdrejti profesionin tuaj, karrierën tuaj.

Unë dua t'ju jap dy orientime. Ju ngrini shqetësimin e statusit. Unë po jem them se ka qenë edhe shqetësimi ynë.

Çfarë është statusi? Statusi fillon që me çështjen financiare, për të cilën ne kërkojmë të gjejë rregullim. Patjetër që edhe ju e kërkon këtë gjë. Statusi ka të bëjë me çështjet e pozicionimit tuaj në raport me ndonjë mbrojtje të posaçme ligjore. Statusi ka të bëjë me armëmbajtjen, që është një kërkesë e OPDAT-it, e cila patjetër që do të gjejë pasqyrim. Prandaj unë nuk dua të ndalemi të formulime termash te drafti, por dua të ndalemi te problematikat, për të cilat ju gjykoni se duhet të gjejnë rregullim. Ne jemi duke punuar bashkë me ekspertët për rikonceptimin e të gjitha neneve. Ju na orientoni te problematika, pra për çështje që ju shqetësojnë jepni propozimet konkrete. Status do të thotë edhe mundësi e të bërit karrierë dhe ka mundësi. Së pari, po e nis nga fundi i asaj që thatë ju, pra nga mundësia për në Shkollën e Magjistraturës, e cila është e hapur për këdo jurist në Republikën e Shqipërisë që kalon konkursin, pra do t'i nënshtroheni konkursit. Ju është hequr vërtet mundësia e t'u bërit prokurorit thjesht me vështirësi në punë, ku një pjesë e oficerëve janë bërë. Duhet të jemi realistë. Nuk ka qenë automatikisht aty që kushdo, që është oficer i Policisë Gjyqësore, të bëhet prokuror. Madje, një pjesë e vogël është bërë prokuror, madje shumë më tepër se kaq, është bërë drejtues prokurorie. Por kjo ju është hequr dhe ne për këtë arsye duam të bëjmë një rregullim tjetër të saktë që t'ju nxitim dhe t'ju motivojmë ju që ta bëni punën me dëshirë. Një mundësi karriere është të qenurit oficer i Policisë Gjyqësore në një shkallë më të lartë se në një prokurori rrethi, siç është Prokuroria e Përgjithshme. Ju duhet të kuptoni se karriera nuk ka të bëjë gjithmonë me çështjen e pagës, pra nëse nuk e ke pagën më të lartë, të garantoj që ke statusin më të lartë si oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme. Këto janë çështje, të cilat edhe ne vetë i kemi shqetësim dhe do të dëshironim të merrnim propozime konkrete, mbase jo vetëm këtu, por mund të na i sillni me shkrim brenda javës tjetër, sepse ne kemi edhe një kalendar dhe duam që, nëse do të jemi në gjendje ta përmbushim këtë ligj ashtu siç gjykojmë ne, ta kalojmë në korrik. Para se ta kalojmë në korrik, pra para se t'ia kalojmë seancës plenare, duhet t'i ezaurojmë diskutimet në Komisionin e Ligjeve.

Po, zonja Qeleshi.

Joana Qeleshi – Përshëndetje!

Në fakt, kam disa konsiderata të përgjithshme, duke qenë se shoq

H që diskutimi shtrohet të paktën, së pari, në një ndarje shumë të madhe, pra për një vendim që ju, si komision, duhet të merrni për modelin që do të zgjidhni. Pra, nëse Policia Gjyqësore do të jetë një strukturë më vetë që do të merret me hetimin, siç edhe propozohet, pak a shumë, në projektligjin që kemi përpara, nëse do të vazhdojë të jetë siç është tani, apo

nëse do të jetë një alternativë ndërmjet prokurorisë dhe Policisë Shtetit, por më garantuese sesa aktualisht. Mendoj se këto çështje duhet të ndahen që në fillim, në mënyrë që të kuptohet nëse do të vazhdohet me projektligjin që është apo do të ketë një rregullim tjetër.

Ajo që dua të them unë është se, veçanërisht pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjeve të tjera, forcim si i kapaciteteve njerëzore, por edhe i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Policisë Gjyqësore, të paktën në punën e përditshme qoftë të prokurorëve, qoftë të gjyqtarëve, është shumë evidente. Mjafton t'ju sjell këtu faktin se, me futjen e gjyqtarit të seancës paraprake, të gjitha veprimet, që mund të kishin pavlefshmëri apo problematika qoftë për shkak të mosnjohjes së mirë të ligjit, të një neglizhence apo të një praktike të gabuar në disa raste të oficerëve të Policisë Gjyqësore, por edhe për shkak se 90%-95 % e rasteve të gjykimit të shkurtuar mbuloheshin dhe nuk evidentoheshin nga gjyqtarët, sot janë të pamundura për t'u mbuluar, sepse edhe kur kërkohet gjykim i shkurtuar, gjyqtari ka detyrimin të kalojë më parë çdo pavlefshmëri apo papërdorshmëri. E them këtë për të treguar se sa e rëndësishme është që oficerët e Policisë Gjyqësore të kenë vërtet trajnimet dhe njohuritë e duhura për sa u përket jo vetëm aftësive të tyre për të hetuar, që janë aftësi që fitohen në arsimin përkatës sipas Akademisë së Policisë apo trajnimet e ndryshme që kryejnë, por edhe njohuritë e duhura ligjore për të zbatuar siç duhet kuadrin ligjor dhe për të mos shkaktuar pavlefshmëri të tilla, të cilat në proces do të ishin të pamundura të rikuperoheshin. Duke thënë këtë, pavarësisht modelit që ju do të vendosni të zgjidhni, ndoshta opinionet e mia personale për atë që mendoj se është më e përshtatshme mund t'i çoj me shkrim. Por ajo që unë vlerësoj se do të ishte e domosdoshme në çdo rast, është që të garantohet statusi i oficerit të Policisë Gjyqësore në cilindo variant si një person i cili, në qoftë se është trajnuar dhe që duhet të ketë trajnim të vazhdueshëm, i kualifikuar për atë pozicion, të ketë garanci për të mos lëvizur, sepse ky është një nga problemet kryesore që ne kemi hasur në çështje të ndryshme.

Flasim për krimin ekonomik. Prokuroritë më të mëdha kanë struktura të posaçme. Një oficer sa fillonte punën, pas një muaji apo dy muajsh nuk ishte më. Kjo shkaktonte dëme shumë të mëdha në hetim, të cilat më pas reflektoheshin edhe në gjykim. Kështu që, nëse do të vazhdohet me modelin aktual, pra që nuk do të kishte nevojë për një ligj të ri, por një projektligj me shtesa dhe ndryshime në ligjin aktual apo nëse zgjidhet një model që oficerët e Policisë Gjyqësore të jetë një strukturë midis prokurorisë dhe policisë, duke rritur garancitë në pozicionin që gjenden, mendoj se duhet të parashikohet shumë mirë jo vetëm statusi i tyre, por edhe se cilat do të jenë kushtet apo të garantohet qëndrimi i tyre në detyrë. Mendoj se ky është merakun më i madh nga pikëpamja e cilësisë së produktit që merret nga veprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Gjej të rëndësishme, gjithashtu, pavarësisht se cili do të jetë ligji, të sjell në vëmendjen tuaj që dispozita kalimtare duhet të jetë shumë e qartë dhe e mirëformuluar për faktin se, pavarësisht sa të qarta apo çfarë problemesh mund të kenë pasur ligjet e tjera, kemi hasur në praktikë interpretime të ndryshme dhe problematikë në zbatimin e tyre. Unë sugjeroj, sepse nuk është në teknikën tonë legislative përdorimi i ditëve, që nuk e kemi nëpër ligje, duke përjashtuar vetëm dy ligje të paketës së reformës në drejtësi. Kur përcaktohen numra ditësh shkaktohet problematikë jo vetëm që nuk e kemi në traditë, por edhe për faktin se diskutimi nis se kur do të fillojë apo kur do të mbarojë dita e 240-të apo dita e 270-të. Kështu që sugjerimi im është që të ndiqet teknika legislative që ne kemi pasur gjithmonë, brenda 6 muajve ose brenda 3 muajve dhe të mos vendosen afate para krijimit të KLP-së, sepse ende nuk e dimë se kur do të krijohet dhe do të jetë e njëjta situatë si për Gjykatën e Krimeve të Rënda ashtu edhe për gjykatën e posaçme, që nëse e lidhim me 240 ditë nga hyrja në fuqi e ligjit para se të krijohet KLP-ja, do të kemi situata që mund të shkaktojnë probleme. Meqenëse e kemi një eksperiencë të keqe nga kjo, unë mendoj se duhet të mësojmë nga këto eksperiencia dhe do të ishte mirë që të mos ndodheshim para kësaj situatë.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Zonjusha Qeleshi, populli shqiptar ka një shprehje “Kur të djeg qulli i fryn kosit” dhe tashmë ne jemi djegur me këto çështjet e dispozitave kalimtare dhe ekspertët nuk janë në të njëjtën fazë diskutimi në këtë aspekt, por ndoshta zoti Ligori mund ta shpjegojë vetë.

Henrik Ligori- Në fakt, unë dua të bëjë disa saktësime, në mënyrë që të fokusohemi në disa çështje kryesore që duhet të diskutohen sot.

Projektligji që kemi para parashikon se, që shërbimet e Policisë Gjyqësore të jenë efektive, duhet të jenë të grupuara në trupa të veçantë. Fillimisht, pas Dokumentit Analitik për studimin e sistemit drejtësisë penale në Shqipëri, ky ishte modeli, ku të gjithë u ofruan dhe thanë se do të krijojmë seksione me fuqi shumë të reduktuar dhe shërbime të Policisë Gjyqësore, të cilat do të funksionojnë mbi bazën e zyrave të veçanta. Pra, në Policinë e Shtetit do të krijohet një drejtori e veçantë e Policisë Gjyqësore, e cila do të kryejë vetëm hetime në funksion të prokurorit; në dogana do të ketë një zyrë, e cila do të kryejë vetë veprimtari hetimore dhe do të funksionojë si polici gjyqësore; në Policinë Pyjore do të ketë një zyrë, e cila do të kryejë hetime sa herë kryhen vepra të natyrës që mbron kjo strukturë. Duke qenë se kjo strukturë do të ishte shumë e lidhur me hetimin që kryen prokuroria, atëherë brenda Këshillit të Lartë të Prokurorisë do të krijohej një komision i posaçëm i Policisë Gjyqësore, i cili do të merrej me rekrutimin, me promovimin dhe do të jetë si seli disiplinore në rastet e shkeljeve.

Krijimi i këtij komisioni do të kishte kuptim në qoftë se oficeri i Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit do të rekrutohej sipas rregullave dhe kriterëve që parashikon ligji i posaçëm i Policisë së Shtetit, por nëse ky do të donte të kryente funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore, duhet të kalonte nëpërmjet komisionit, i cili do ta emëronte në detyrën e oficerit të Policisë Gjyqësore. Madje nëse e shohim ligj, ai parashikonte edhe disa trajnime të posaçme para se të merrte funksione të kësaj natyre, por nga diskutimet e mëvonshme pati tendencë për t'u larguar nga kjo. Në qoftë se e dëgjuat zotin Rica, ai tha se funksionin e Policisë Gjyqësore do ta marrë nga struktura ku ai bën pjesë, pra sipas ligjit të Policisë së Shtetit. Nëse oficeri emërohet në seksionin që heton krimin, automatikisht ai i fiton funksionet gjyqësore dhe kjo e bën të panevojshëm komisionin e Policisë Gjyqësore, i cili është parashikuar që të ngrihet pranë KLP-së. Kështu që ne jemi në dy drejtime konvergjente, të cilat duhen zgjidhur. Ky debat duhet të fokusohet se çfarë modeli duhet të zgjedhim, sepse në qoftë se ikim nga ky model, që është paraqitur projektligji, atëherë çdo gjë ndryshon dhe gjërat duhen diskutuar nga e para mbi bazën e atij ligji që ne kemi sot, i cili ka nevojë për përmirësime.

Një problem tjetër është ai i seksioneve. Ne nuk mund t'i eliminojmë dot seksionet, sepse ato i parashikon Procedura Penale. Ndoshta do të ishte më mirë që hetimet t'i kryenin organet e ekzekutivit dhe seksionet të fshiheshin, ashtu siç e tha zoti Muçi, gjë që nuk e bëjmë dot tani, por kemi rënë në ujdi që seksionet do të dobësohen dhe nuk do të kenë fuqinë që kanë sot, sepse hetimet do t'i kryejë Policia e Shtetit.

Problemi tjetër është se kush do t'i emërojë oficerët e policisë së seksioneve, të cilët i emëronte Prokurori i Përgjithshëm, por që sot nuk e ka më këtë pushtet?! Ju mund të na sugjeroni se si do të rekrutohen dhe si do të largohen nga detyra oficerët e seksioneve, të cilët do të vazhdojnë të ekzistojnë.

Së dyti, ju si oficerë të Policisë Gjyqësore mendoni se struktura e hetimit penal të përqendrohet në zyra të veçanta apo çdo oficer i Policisë Gjyqësore, i cili është i caktuar në një seksion, që merret me hetimin e krimit, të fitojë automatikisht këto funksione?

Problem tjetër për seksionet është ai i pagës. Ju duhet të jeni të qartë në kërkesën tuaj se çfarë page synoni.

Duhet të jeni më konkretë në terma.

Koraljka Bumçi – (përkthen përkthyesja) Për këtë unë kam një zgjidhje dhe besoj se mund t'ju ndihmoj duke iu referuar nenit 20 të ligjit për statusin, ku ka një kategorizim të pagesës së magjistratëve, si për shembull, 70% e një shume dhe kështu me radhë. Pra, aty keni nivele të ndryshme dhe mund t'i merrni si orientuese.

Dritan Reshka – Dua të plotësoj atë që tha Henriku, i cili preku pjesën e pagës, pra dha një lloj shpjegim si do të jetë pozicioni dhe rëndësia e seksioneve. Ju duhet të dilni me një propozim. Sot të gjithë oficerët e Policisë Gjyqësore rekrutohen nga prokurori i Përgjithshëm dhe ju e dini këtë. Në kushtet e organizimit të ri dhe funksionimit të prokurorisë, çdo prokurori e çdo rreth gjyqësor merr rëndësinë e vet. Në këtë mënyrë rritet niveli i administrimit apo i vetëfunksionimit. Çdo prokurori, duke filluar nga e Përmetit deri te e Shkodrës apo Tropojës, në varësi të ngarkesës së punës, në një moment të caktuar identifikon nevojën për të marrë një oficer të Policisë Gjyqësore. Si do ta rekrutojë? Do t'ia lëmë prokurorit të Përgjithshëm apo ka një mekanizëm tjetër, atë që propozojmë ne, një komision *ad hoc*, sepse nuk do të jetë i përhershëm?

Kini parasysh që sot kemi 160 të tillë dhe ndoshta për një vit, në qoftë se do të ketë mbështetje, do të mund të kemi vende të lira për të zëvendësuar ata që dalin në pension apo një pjesë që mund të emërohen shtesë. Ky komision do të ngrihet vetëm kur të jetë e nevojshme, jo gjithmonë. Pyetja është nëse do t'ia lëmë vetëm një organi individual apo një grupi. Ndaj propozuam, që, në çdo prokurori, kur ka nevojë drejtuesi për një prokuror që caktohet me short apo për një oficer të Policisë Gjyqësore që caktohet po me short, të ngrihet një komision *ad hoc*. Hapet aplikimi, merr dokumentet dhe përzgjedh oficerin e Policisë Gjyqësore sipas nevojës që ka.

Kjo është një formulë, por nëse keni të tjera ju mirëpresim të na i thoni dhe t'i marrim në konsideratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kam një pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme. Ne kemi bërë disa tryeza diskutimi për këtë çështje dhe unë kam një pyetje. I qëndroni idesë që marrja e statusit të oficerit të Policisë Gjyqësore brenda strukturës policore, nga ana juaj do të konsiderohet ngritje në detyrë si sistem karriere?

Dua ta shtjelloj pak idenë time. Që trupa e Policisë Gjyqësore është përcaktuar në një ligj të votuar me 84 vota, siç është Kodi i Procedurës Penale, kjo çështje nuk mund të diskutohet në këtë tryezë. Ne po diskutojmë çfarë kostumi do t'i veshim këtij trupi. Do t'ia veshim në ngjyrë të zezë, të kuqe apo jeshile është e shkruar këtu. Të mos ngjitem më lart në Kushtetutë ku janë përcaktuar funksionet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurorit të Përgjithshëm, SPAK-ut, Byrosë Kombëtare të Hetimit e kështu me radhë. Ne sot po diskutojmë thjesht ngjyrën e kostumit. Duhet të zgjedhim disa probleme me Policinë Gjyqësore, sepse në dokumentin analitik të reformës në sistemin e drejtësisë, e tha profesor Hoxha, është evidentuar qartë mungesa e pasjes së një sistemi karriere në Policinë Gjyqësore; mungonte kontrolli dhe

masat disiplinore mbi oficerët e Policisë Gjyqësore për problemet që kishin të bënin me cilësinë e hetimit, zvarritjen e hetimit e kështu me radhë.

Më pas ishte forma e bashkëpunimit të oficerëve të seksionit me institucionet e varësisë. Nga ju, prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore, ka dalë shprehja e famshme: “Oficerët e Policisë Gjyqësore të seksionit janë si gruaja me dy burra”, varësinë administrative e kanë në Policinë e Shtetit, kurse varësinë procedurale e kanë në prokurori. Të gjithë sa jemi në këtë tryezë jemi vartës të prokurorit në raport me hetimin dhe ndjekjen penale. E ka thënë Kushtetuta dhe Kodi i Procedurës Penale. I gjithë aktiviteti ynë është në funksion të hetimit. Kush e drejton hetimin dhe ndjekjen penale? E drejton prokurori. Ky ligj do të shërbejë si rrip transmissioni duke bërë një lidhje midis Policisë Gjyqësore, atje ku gatuhet hetimi, dhe prokurorit, duke pasur Kodin e Procedurës Penale në mes.

I kthehem kësaj ideje, sepse në një diskutim që kemi bërë me Policinë e Shtetit është marrë një shembull konkret. Marrim shembull zyrën rajonale të drogës në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Sot ka shtatë oficerë me gradën inspektor. Varianti i parë që është diskutuar ka qenë, që, nga faza e parë e gjurmimit policor për të kaluar në fazën e hetimit brenda zyrës, njëri nga oficerët e zyrës të kishte atributet e hetimit, pra të ishte pjesë e seksionit të Policisë Gjyqësore. Kjo u kundërshtua me argumentin se do të shkëpuste gjurmimin policor me fazën e hetimit. Më pas u shtrua pyetja: Cili do të ishte interesi i pesë oficerëve të tjerë të zyrës në rast se do kryenin të gjithë veprimtarinë policore dhe hetimin do ta merrte një nga oficerët e zyrës? Kjo ka qenë dilema dhe kundërshtia e parë brenda strukturave policore.

Mirëpo, ky mendim, në vlerësimin tim, edhe në atë kohë ka qenë i gabuar. Hetimi nuk mund të jetë i ndarë në parcela, sepse Policia e Shtetit duhet konceptuar si një e tërë në funksion të hetimit dhe ndjekjes penale. Në fund të fundit, cili është qëllimi i luftës kundër krimit dhe korrupsionit e të tjera? Është ndëshkimi. E gjithë struktura policore është në funksion të këtij qëllimi. Ideja është që brenda zyrave rajonale, apo siç e keni organizuar ju me ligjin organik të Policisë së Shtetit, të ketë një nukël hetimi. Nga ana juaj kjo do të shikohej si sistem karriere dhe do të zgjonte edhe interesin e pjesës tjetër, që, nëse do të kishte dëshirë të ishte pjesë e hetimit, të përmirësonte vazhdimisht cilësinë e punës së saj në strukturës policore. Kjo ka qenë ideja fillestare dhe prandaj sot kemi ardhur te ky projektligj. Këtu e kam fjalën për modelin.

Jeni me idenë fillestare apo keni avancuar rrugës? Çfarë propozimi keni, pavarësisht se unë e di që ju keni dhënë mendime konkrete? Kodi i Procedurës Penale këto ide jep. Profesor Hoxha tha që ne kemi marrë për bazë organizimin e BKH-së, por me disa specifika për mënyrën e rekrutimit apo kritere që duhet të plotësojnë oficerët e Policisë Gjyqësore. Kërkoj nga ju që ta shtjelloni pak idenë.

Nikoll Rika – Zoti kryetar, më lejoni të bëj një sqarim për pyetjen që ju bëtë.

Është i vërtetë fakti se edhe më parë është diskutuar ideja që ju thatë dhe, duke marrë mendimin e të gjithë ekspertëve të policisë, është lënë që strukturat, të cilat merren me hetimin e veprave penale, pra një punonjës policie, që është edhe inspektor i policisë kriminale, që ka dy armë në duar për të zbuluar dhe për të hetuar veprat penale: dosjen e procedimit policor, që shfrytëzon rrjetin, burimet e informacionit e të tjerë, kanë edhe tagrin që i jep Kodi i Procedurës Penale, që ju thoni për të kryer edhe veprime hetimore.

Është i vërtetë fakti se nga 9700, ose rreth 10 mijë punonjës policie nuk i kanë kryer asnjëherë hetimet të gjitha, jo se nuk i kanë gëzuar, pra instituti i gëzimit është tjetër gjë dhe e kemi të përcaktuar në nenin 18 të ligjit, që çdo punonjës policie i gëzon sot këto attribute, ndërsa ushtrimin e kemi lënë në dorën e atyre specialistëve të Policisë së Shtetit, që kanë të drejtë për të bërë referimin e veprës penale te prokurori dhe specialistët.

Për sa i përket pyetjes që ju bëtë për efekt të karrierës, faktikisht, në pikën 1 të nenit 51 e ligjit “Për Policinë e Shtetit” e kemi të përcaktuar karrierën e menaxhimit në Policinë e Shtetit. Pra, kjo karrierë është e përcaktuar në bazë të gradave që janë të miratuara në ligjin e policisë.

Ne e kemi të përcaktuar në këtë formë: cila është karrierë, një punonjës policie që ka një gradë më të lartë, ai është menaxher dhe, si të thuash, ka karrierë më të lartë. Në qoftë se dy punonjës policie janë me të njëjtën gradë policore, atëherë menaxhimin do ta kryejë ose e ka karrierën ai punonjës policie që ka vjetërsi më të madhe në punë.

Për sa i përket përcaktimit ose rregullimit të atyre personave që duhet të shërbejnë në strukturat e hetimit të krimit, që kanë edhe atributet e oficerit që kryen hetime, sipas KPP-së, kjo ngjall diskutim, pasi ne themi që sot për sot ka një problem te policia, që nuk është ndjekur kriteri i mirëfilltë dhe personat të cilët kanë më shumë përvojë në hetimin e krimit janë lëvizur herë pas here nga një strukturë në një strukturë tjetër dhe kështu fle hetimi, pra ka pasur probleme, por unë them ta shohim si element të profesionalizmit, ndërsa si element të karrierës ta shohim me gjithë pjesën tjetër të policisë.

Përderisa menaxhimi shikohet mbi bazën e gradave, pra karriera në polici ka në thelb sistemin e gradave, edhe karriera e krijon një problem, sepse karrierë mund të quhet edhe ajo, siç u tha nga oficeri i Policisë Gjyqësore: nëse merr një pagë më të lartë karshi meje, që jam specialist i rendit me gradën “nënkomisar”, një tjetër, që është specialist i policisë kriminale, merret me hetimin e krimit, për shkak të vështirësisë, mund të ketë një pagë më të lartë në përqindje.

Pra, paga për gradë është njëlloj, ndërsa vështirësia mund të jetë 20% ose 30% më e madhe. Ky është një motivim, në njëfarë mase po e quajmë edhe si karrierë, por për efekt të karrierës së menaxhimit policor nuk mund ta quajmë karrierë këtë, pasi karrierën unë e lidh me sistemin e gradave.

Pastaj, kur flitet për sistemin e gradave, janë të përcaktuara kriteret: duhet të kesh pesë vjet për të qenë nënkomisar, tre vjet për të qenë komisar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në ligjin “Për Policinë e Shtetit”.

Artan Hoxha – Si e lidh me këtë, është pyetja? A i mbetet ministria këtij versionit? Sepse ky është një version, nuk është...

Ajo që po mundohet të thotë edhe zoti Manja është se kemi dy ligje sot: ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe ligjin “Për Policinë Gjyqësore”, pra atë që kemi në fuqi dhe atë që propozohet. Tani është thelbësore. Ligji i propozuar është shumë rrënjësor në raport me atë ekzistues në ndryshimet e tij. Pyetja është, sepse mund të krijojmë konfondim, po diskutojmë për një projekt që është i pranuar nga ministria, apo po diskutojmë për një paraprojekt, i cili ka ende elementet thelbësore? Sepse këtu ka elemente thelbësore, pasi është modeli që do të zgjedhësh. Ky model i zgjedhur e përqendron Policinë Gjyqësore, e ndan nga pikëpamja e organizimit, nga funksionet policore; krijon struktura mikse me prokurorinë, krijon edhe një drejtori me një drejtor të Përgjithshëm të Policisë Gjyqësore. Pra, në diskutimet që unë kam pasur më herët për sa i takon ligjit për SPAK-un, nuk është se ministria ka qenë shumë dakord me një ndarje të tillë. Është thelbësore që të vendosen piketat kryesore në fillim, se pastaj elementet e tjera, që kanë të bëjnë me karrierën dhe me statusin, ato që nuk rregullohen nga ligji “Për Policinë e Shtetit”, plotësohen te ligji “Për Policinë Gjyqësore” po të japim elemente shitesë.

Nuk besoj se është problematikë, por është vetëm çështje e të shkruarit.

Problemi është konceptual: i mbetemi fillimit të reformës, apo ka ecur ndonjë gjë në këtë drejtim? Se ky është projekti. Bisedojmë për këtë projekt, apo edhe për elemente të tjera?

Faleminderit!

Nikoll Rica – Në përgjithësi ky projekt ka marrë në konsideratë edhe mendimet që ka dhënë Policia e Shtetit, pra ne kemi dhënë mendime dhe në thelb i përmbahemi atij projekti që është bërë dhe që po e diskutojmë.

Siç e tha edhe zëvendësministri, i vetmi thelb që ndryshon është këtu që, për sa i përket rekrutimit, ka një problem, sepse ligji bazë është ligji i policisë, që nuk dalim ndryshe.

E dyta, lidhur edhe me pyetjen e bërë për sa i përket formimit, në Akademinë e Policisë ofrohen të gjitha programet për këto nivele që po diskutojmë qoftë në sistemin e parë, në Kolegjin Profesional; qoftë në Bachelor, qoftë në Master.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Faleminderit!

Mes nesh i kemi pasur të qarta, sepse i kemi diskutuar, por disa diskutime bëhen këtu edhe për efekt të aktorëve të tjerë që i janë shtuar këtij diskutimi sot. Prandaj, zoti Rica, shumë mirë që i bëtë sqarimet!

Fjalën e ka zoti Beluri.

Kosta Beluri – Në vlerësimin tim, patjetër që duhen marrë mendimet e aktorëve këtu, por ekspertët duhet të bazohen më shumë te Dokumenti Analitik për ta draftuar ligjin.

Duke pasur parasysh problemet që ka nxjerrë Dokumenti Analitik, unë them që do të anashkalojmë disa pretendime qoftë të policisë, qoftë të prokurorisë, qoftë të institucioneve të tjera.

Për të kontrolluar atë që unë kam në mendje, që nuk bie shumë ndesh me çfarë propozon Ministria e Brendshme, fakti që këta pranojnë të krijojnë seksione në komisarjat, nuk ka asgjë të keqe të krijojnë seksione edhe në drejtoritë e policive, në të cilat të përfshihen specialistë nga të gjithë sektorët e tjerë të hetimit: droga, trafiket.

Ne duhet të ndryshojmë mentalitetin e punës brenda për brenda Policisë së Shtetit. Nuk ka logjikë të thuash se nuk bashkëpunon sektori i drogës me sektorin e hetimit, sepse nuk i çon informacion. Ligji duhet ta ndryshojë këtë mentalitet dhe të detyrojë patjetër bashkëpunimin e këtyre sektorëve të veçantë me sektorin e hetimit për të mundur një hetim sa më cilësor.

Tani, për sa i përket mënyrës që them unë, nëpërmjet krijimit të këtyre seksioneve të hetimit, seksioneve të Policisë Gjyqësore, e bën më të lehtë edhe organin kolegjal, komisionin a çfarë do të krijojmë ne për të ndrequr problemet e tjera, që lidhen me transferime, komandime, shkelje disiplinore, madje bën më të lehtë edhe parashikimet për statusin, se i përfshin të dyja strukturat.

Alket Hyseni – E qartë, zoti Beluri!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që do ta merrni fjalën, pasi janë edhe disa institucione, të cilat kanë atributet e Policisë Gjyqësore.

Ju ftoj tani të diskutojmë rreth disa aspekteve edhe praktike, se, për shembull, nuk mund të mbajmë më doreza. Deri sot, me ligjin aktual, edhe pse nuk është ligj i keq, ndodh që shefi i komisarjatit, drejtori i policisë, le të themi, policia, e përmendët ju, e transferon oficerin e

Policisë Gjyqësore në mesin e një hetimi dhe, pavarësisht se ligji e përcakton, ka një udhëzim, i cili përcakton se OPGJ-të duhet të marrin miratimin e prokurorit. Ata nuk e marrin fare. Është fakt, që kur e merr vesh prokurori që oficeri i Policisë Gjyqësore është transferuar dhe nuk është më në hetim, ai ka marrë detyrën tjetër. Kjo sjell një ngërç në praktikë, për të mos thënë që nga pikëpamja procedurale, për të cilën unë jam i shqetësuar, kjo mund të sjellë pavlefshmëri të akteve hetimore, të cilat nuk korrigjohen më me sistemin e ri.

Nëse me sistemin e vjetër vetë gjyqtarët shpesh mbyllnin sytë para disa detajeve të vogla të këtij aspekti, që ndoshta mund të ribëheshin, tashmë nuk ka më. Me filtrin e ri të kontrollit, prokurori nuk është më kontrolluesi i plotë, sec këtui kemi shtuar një filtër kontrolli. Tashmë është gjykata që i bën një kontroll hetimit, nëse është momenti për të shkuar në gjyq, apo jo. Prandaj të jemi më praktikë, sidomos për oficerët e Policisë Gjyqësore.

Ne kemi dashur t'i japim peshë prokurorit të çështjes në këto transferime. Nuk thamë që ta firmosë transferimin, se, nëse do të marrim variantin miks, do t'i mbetet institucionit të emërtesës, por, siç kemi thënë, ata marrin emërtim paraprak. Në të kundërt, do të mbajë përgjegjësi organi që ka bërë transferimin, nëse e bën këtë pa miratimin paraprak të prokurorit. Përmenda këtë rast praktik, por ka plot elementë të tjerë, të rëndësishëm për të realizuar misionin, hetimin e saktë dhe të shpejtë.

Ajo që ka ceduar, që e përmendi profesor Hoxha, pra pika më e dobët e sistemit, është hetimi paraprak.

Hetimi paraprak i përket oficerit të Policisë Gjyqësore. Të mos e sjellim debatin në çështjen, nëse do të bjerë dakord policia. Policia është një nga aktorët. Ministria e Brendshme është po ashtu një nga aktorët dhe qeveria e ka të qartë opinionin e vet politik. Qeveria në kuadër të kësaj reforme të madhe, ka parë të meta në hetim dhe për shkak të këtyre të metave ka kërkuar bërjen e një ligji të ri, se ndryshe nuk kishim pse ta diskutonim këtë.

Unë do të doja të ishin këtu edhe kolegët e opozitës, zoti kryetar, sepse ky nuk është një ligj që përfshin vetëm një maxhorancë të momentit, por është një ligj, i cili, mendojmë, do t'i qëndrojë kohës. Kishim dëshirë që ata të ishin pjesë e diskutimeve. Janë ftuar vazhdimisht prej nesh, të paktën kolegët e Komisionit të Ligjeve.

Për të mos ikur nga tema, qëllimi është të bëjmë një ligj më të mirë se ai që kemi dhe ose ta bëjmë me një strukturë të re, ose të përmirësojmë fort këtë ligj që kemi. Ky është thelbi i këtij debati. Ka disa momente ku duhet mendim konkret dhe ku kërkohet diskutim konkret, të cilat unë i shtrova në fillim dhe nuk dua t'i përsëris. Prandaj, të jemi pak më konkretë.

Unë e kuptoj se ideja më e mirë teorike është një trupë e vetme me kompetenca dhe me organe emërtese të përcaktuara. Absolutisht, kjo do të ishte ideale teorikisht.

Ndërkohë, që ne vijmë nga një sistem, i cili nuk e ka të tillë eksperiencën. Ose mund të themi se eksperiencia e hetuesisë është shumë më e ndryshme. Ajo është me sistemin e kaluar.

Unë nuk jam nga ata që them se çdo gjë që ka qenë në sistemin e kaluar është gabim, por po them se tashmë po bëhen 26 vjet që nuk është më ai sistem referimi.

A mund ta fusim? Futja automatikisht e një formule të re me një trupë të vetme, mund të ketë problemet e veta. Këto do të doja t'i diskutonim këtu. Më pas, do të ecim më tej.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Urdhëroni!

Ju lutem, prezantohuni!

Bledar Flaga – Unë jam Bledar Flaga, aktualisht jam oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ndërsa më parë kam qenë oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Tiranës, prej rreth 15 vjetësh.

Doja të tërhiqja vëmendjen tuaj mbi një fakt. Oficeri i Policisë Gjyqësore është guri i themelit të procesit penal. Ai është personi që konstaton faktin kriminal, që evidenton subjektet dhe objektet e procesit penal të mëpasshëm. Si i tillë, institucioni i Policisë Gjyqësore mbart detyrime, por edhe pushtet. Ndaj, garantimi i punës së Policisë Gjyqësore në hetim është një detyrë e ligjit, që duhet zgjidhur.

Në aspektin praktik vihen re disa fenomene konkrete, që e minojnë hetimin, një nga të cilat është influencimi i oficerit të Policisë Gjyqësore gjatë punës së vet. Duhet krijuar instrumente ligjore që e garantojnë oficerin e Policisë Gjyqësore në përmbushjen e rregullt të objektivave të detyrës, që fillojnë që nga paga, nga garancitë profesionale dhe deri te sistemi i karrierës. Ka gjëra edhe më të rëndësishme se këto. Policia Gjyqësore dhe sistemi i hetimit nuk mund të përqendrohen në një dorë të vetme, sepse krijojnë monopol mbi hetimin dhe është një monopol mbi një pushtet, i cili nëse del jashtë kontrollit dhe fabrikon prova apo procese, mund të kthehet në një armë, siç ishte Hetuesia e Përgjithshme. Vende të ndryshme e kanë zgjidhur duke krijuar struktura paralele me të njëjtin objekt pune, por të pavarura nga njëra-tjetra, ndaj ekzistenca e shërbimeve Policisë Gjyqësore nën varësinë e Policisë së Shtetit dhe seksionet e Policisë Gjyqësore nën varësinë e Prokurorisë në perceptimin tim, është e nevojshme dhe e domosdoshme dhe duhet theksuar.

Nëse doni një shembull konkret, mund t'ju jap hetimin e 21 Janarit.

Kjo duhet parë me përparësi. Nuk mundet, është e pakonceptueshme të përqendrohet hetimi në një dorë.

Kaq kisha për aspektin parimor të ligjit. Po ta shohim nen për nen, ligji, me sa kam lexuar, edhe për shkak të kohës së kufizuar, që na u vu në dispozicion, ka një frymë jopozitive, nuk krijon një imazh pozitiv për oficerin e Policisë Gjyqësore. Ka 20 nene, që flasin vetëm për ndëshkimet. Duhet të jetë më i dashur them unë.

Prokurori ka tjetër objektiv dhe oficeri i Policisë Gjyqësore ka tjetër objektiv. Kështu duhet të ndahen njëri nga tjetri, sepse kur i kanë të gjitha në një dorë, fillojnë të marrin për keq. Duhet evidentuar dhe u duhet gjetur zgjidhje problemeve kryesore.

Kaq kisha unë, se për pagat folën shokët.

Alket Hyseni - Faleminderit!

Zoti Doda, shqetësimi juaj është me vend, por duhet të fokusohemi te ligji për Policinë Gjyqësore. Nëse struktura juaj dhe ligji i posaçëm e njohin të drejtën që një kategori e caktuar të ketë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore, ne presim nga ju opinione rreth fokusimit në këtë ligj se çfarë mund të bëjmë më mirë për këtë status. Nuk është objekti këtu që Prokuroria e Përgjithshme të krijojë ndonjë strukturë për këtë çështje. Shqetësimi juaj është me vend, por nuk është kjo tryeza që do ta ndajë. Këtë gjë kërkojani ministrit tuaj ta fusë në ligjin e ri, ju lutem! Nuk është objekt i kësaj tryeze. Faleminderit, zoti Doda!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mendoj se ka shumë tema për t'u diskutuar. Ky nuk është i vetmi vend ku mund të diskutohet. Unë ju ftoj t'i dërgoni me shkrim në adresën e Komisionit të Ligjeve diskutimet dhe propozimet konkrete, që të mos ngelemi thjesht në nxjerrjen e problemeve, sepse ndonjëherë është shumë më e thjeshtë të thuash çfarë çalon, dhe ju garantoj se do të shqyrtohen me përgjegjshmëri. Ne do të vazhdojmë me një format tjetër diskutimesh. Kërkoj mirëkuptimin tuaj për të mos e vazhduar këtë diskutim. Do të dëgjojmë OPDAT-in nëse ka diçka për të folur dhe bashkërelatorja Xhina do të bëjë një rezymë.

Urdhëroni!

Gjon Juncaj – *(përkthen përkthyesja)* Së pari, dua t'ju falënderoj ju dhe kolegët tuaj për mënyrën se si po e drejtoni punën me këtë projektligj!

OPDAT-i ka bërë disa komente të natyrës teknike me shkrim dhe i ka përsëritur edhe në mbledhjet e kaluara, kështu që komentet e mia nuk do të jenë të natyrës teknike.

Mendoj se ka vlerë të flas në përmbyllje të këtij takimi për t'iu kthyer diçkaje që zoti Muçi e përmendi më parë për mënyrën se si është organizuar kjo punë në SHBA dhe për ndryshimet që ekzistojnë mes strukturave shqiptare dhe atyre amerikane. Kuptohet që strukturat janë të ndryshme. Ne në Amerikë kemi një traditë ligjore tjetër nga ajo që keni ju, por mendoj se në të gjitha vendet, në çdo traditë ligjore, pavarësisht se ku ndodhen hetuesit, të

përqendruar në prokurori apo të shpërndarë në institucione të ndryshme, ka diçka të përbashkët në çdo sistem. Strukturat ligjore mund të krijohen në mënyrë perfekte në ligj, por, nëse nuk ka hetues, pavarësisht ku ndodhen këta, që nuk kanë karrierë, nuk kanë qëndrueshmëri në punë dhe nuk paguhen në mënyrën e duhur, sistemi do të dështojë kudo. Mendoj se të gjithë e kuptojmë këtë, sepse këtu jemi për të diskutuar këtë çështje, por doja ta theksoja, veçanërisht duke iu drejtuar kolegëve që janë oficerë të Policisë Gjyqësore, të na tregojnë me shkrim, siç e bën disa kolegë të tyre, duke iu drejtuar komisionit, për të na thënë çfarë është për ta rritje në karrierë. Kjo është një nga mundësitë më të rëndësishme që ata kanë për t'i parashtruar këto çështje, në mënyrë që të merren parasysh në këtë projektligj.

Faleminderit për mundësinë!

Shpresoj ta shfrytëzojmë të gjithë këtë mundësi për të dhënë mendime, veçanërisht kolegët që janë oficerë të Policisë Gjyqësore.

Elena Xhina – Faleminderit! Unë dua t'ju falënderoj të gjithëve për praninë tuaj në këtë tryezë!

Mendimet, gjetjet, rekomandimet dhe sugjerimet janë shumë të vlefshme për këtë projektligj, pasi jemi në një moment që drafti do të marrë rrugëtimin e tij dhe të gjithë duhet të reflektojmë për të pasqyruar problematikat e lindura nga dokumenti analitik.

Synimi i projektligjit është të zgjidhë problematikat e lindura që janë pasqyruar gjatë dokumentit analitik dhe është e rëndësishme të forcohet roli i oficerëve të Policisë Gjyqësore, si në kryerjen e hetimeve, edhe në marrjen e përgjegjësisë nga oficerët e Policisë Gjyqësore, sepse, siç e thamë, janë një hallkë mjaft e rëndësishme e hetimit. Të paktën, të gjithë ata që kanë punuar në terren, i kuptojnë vështirësitë që hasin oficerët e Policisë Gjyqësore. Nga ana tjetër, qëllimi i projektligjit është të përcaktojë qartë parimet, shtyllat dhe kornizën ligjore që do t'i përmbahet në frymën e tij në vijim.

Gjithashtu, synohet të jepet një dimension i ri i statusit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, duke gjetur mekanizmat e duhur, që ata të kenë garanci, qëndrueshmëri, vijueshmëri në karrierë e të tjera.

Po ashtu, synojmë të përcaktojmë qartë kornizat ligjore të kontrollit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, që ata të mos përqendrohen në një dorë të vetme dhe të përcaktohen qartë liritë dhe të drejtat e tyre të veprimit brenda kuadrit të funksionimit si oficerë të Policisë Gjyqësore. Rekomandimet dhe gjetjet tuaja do të pasqyrohen në projektligj, ato që besoj se gjejnë edhe rakordimin e grupit të punës, dhe do t'ju lutesha që çdo rekomandim dhe gjetje që u bë sot të dërgohet me shkrim pranë komisionit, që të pasqyrohen.

Siç e tha edhe zoti Gjon, është mundësia e vetme që u jepet oficerëve të Policisë Gjyqësore, ndaj, ju lutem që rekomandimet e tyre, të argumentuara saktë, të paraqiten pranë komisionit.

Ne si relatorë jemi shumë të përgjegjshëm dhe e kuptojmë përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë që të punojmë fort që projektligji të jetë në shinat e duhura dhe të mos i rikthehemi sërish pas disa vjetësh. Faleminderit për prezencën tuaj!

Jemi të hapur të jemi pranë komisioneve kur kemi oraret tona të punës.

MBYLLET MBLEDHJA